

TADEJ GOLOB
KËMBËT E DERRIT
ROMAN

BOTIMET TOENA

TADEJ GOLOB

KËMBËT E DERRIT

roman

Përktheu nga origjinali sllovenisht
Nikollë Berishaj

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Autori: Tadej Golob
Titulli në origjinal: Svinjske nogice
Botuar në sllovenisht nga: Litera

Ky përkthim u mundësua me mbështetjen financiare të Agjencisë Publike të Librit, Slloveni.

Ky botim u realizua edhe me mbështetjen financiare të Fondacionit Trubar, të Shoqatës së Shkrimtarëve Sllovenë në Lubljanë, Slloveni.

Ta knjiga je bila objavljena s pomoćjo Trubarjevega sklada pri Društvu slovenskih pisateljev, Ljubljana, Slovenija.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Besa Vila
Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-46-6

© Tadej Golob
© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
Email: redaksia@toena.com.al
botimet.toena@gmail.com
www.toena.com.al

PJESA E PARË

Një

Filloi në muajin nëntor. Së paku më duket se ishte nëntor dhe atëbotë ndodhi pika e thyerjes. Binte shi, këtë e kujtoj. Ashtu është, por ky është muaj i vjeshtës dhe në këtë muaj kështu është moti. Ndonëse nëntori, në fakt, nuk është muaji më i keq i vitit, të gjithë thonë se është, ankohen se dita është e shkurtër, se është ftohtë, bie shi, pra në përgjithësi është një kohë e dhjerë. Mirëpo, nuk është ashtu. Problemi ishte në Ditën e të Vdekurve, që është mu në fillim të muajit, por që e dhjenë deri në themel tërë çështjen. Kujtohem që të gjithë qëndrojmë rreth varrezës, fillimisht në anën e njerëzve të nënës, pastaj në anën e atyre të babës. Dy herë kemi konfliktuar pranë varrezës së familjarëve të nënës dhe dy herë pranë asaj të anës së babës. Aty i presim gjyshet tona ta këndojnë këngën “Të lutemi na ndihmo”. Gjyshi është i shtrirë në tokë dhe hesht. Kuptohet se hesht pasi është i vdekur dhe është në dhe. Ishte krejt i vogël kur e varrosëm dhe më kujtohet se dheu ishte i kuq, i ngjithshëm dhe,

edhe atëherë, binte shi si me tërbim. E di se plaku ishte i mërzitshëm, kur ishte ende gjallë dhe rrinte me shkop në dorë para shtëpisë së vet në Dolenjska dhe na shikonte mërzitshëm, por prapëseprapë e doja. Në bankën e dërrastë, në të djathtë të tij, rritej një dardhë, një specie e vjetër, *tepka*, ashtu më duket se e quanin. Nën të ishte një kodër me bar dhe pas meje, që shikoja lart nga kjo kodër, ishte një depo dërrasash për vegla, si parmendë, presë për shtypjen e rrushit dhe të mollëve, por edhe vegla të tjera. Një kohë të gjatë mendoja se ekzistonte një diçka e veçantë që e doja plakun. E tani, qëkur kam Simonin, më duket se fëmijët duhet t'i duan pleqtë dhe në përgjithësi të afërmit dhe e shoh se kjo ishte ajo diçkaja. Ndonëse, ndoshta edhe ishte i mirë, nuk e di, shikonte mërrolshim. Kishim të ftohtë, sepse zakonisht binte borë. Pastaj shkonim tek të afërmit nga ana e babës dhe nëna mbante qëndrim sepse i ngriheshin nervat. Hanim poticë¹. Të vjetrit pinin verë dhe bisedonin, fëmijët pinim qumësht apo lëng nga shurupi. Unë pija lëng, sepse mbi qumësht ishte krijuar një shtresë maze e këtë nuk mund ta gëlltisja. Pija vetëm qumështin Alpin, se ai nuk krijonte shtresë maze, ose më mirë ishte shtresë aq e hollë sa nuk ndihej. Fëmijët e tjerë pinin edhe lëng, por edhe hanin salsiçe me poticë. Gati të gjitha njëkohësisht. Më dukej e çuditshme që

¹ Poticë - Ëmbëlsirë tradicionale sllovene.

nuk i villnin të gjitha. Gati nuk mund t'i kuptoja, pasi e përziemin të folmen me atë theksin e Dolenjskës, por nuk ishin grindavecë, luanim për qejf njëri me tjetrin. Askurrë nuk rriheshim dhe kur ktheheshim, pothuajse edhe më vinte keq që ndaheshim, sepse kjo ishte e vetmja ditë në vit që nuk do të flija saktësisht në tetë të mbrëmjes. Nëse e kujtoj si duhet, por në fakt më dilte parasysh vetëm pjesa e parë e ditës, ajo që e kalonim pranë varrezave, por dhe bisedat e kota mes të rriturve në fillim të mbrëmjes. Ndërsa krejt kohën tjetër, megjithëse nëna në çdo mënyrë dëshironte grindje, këtë e harroja. Luaja me ata dhe grindjen e kujtoja vetëm rrugës për në shtëpi. Heshte e prekur, gjithmonë, çdo vit. Babai shikonte nëpër xhamin e përparmë, i tëri i skuqur, edhe për faktin se kishte pirë paksa, dhe e shtrëngonte timonin. Një ditë do ta vras, thashë me vete dhe çuditesha sesi nuk e kuptonte nëna një gjë të tillë. Zakonisht kjo ndodhte pranë Vishnja Gorës, kur kalonim nëpër rrugën e vjetër drejt Grosuples, sepse, kuptohet, atëherë nuk kishte autostradë.

Kështu, për sa i përket kësaj, nuk më duket e pakuptueshme që, për shumicën e njerëzve, nëntori ishte dita më e keqe e vitit, sepse më dukej sikur shihja përreth meje varrezat dhe të gjitha dukeshin si një mallkim, që fshihnin trauma brenda vetes, e që do të shpërthenin pikërisht në ditën e të Gjithë Shenjtorëve si të donin ata që preheshin në varreza,

t'u hakmerreshin atyre që ishin gjallë. Sikur nuk i kishin munduar mjaft derisa ishin gjallë. Duhet të ketë diç ky 1 nëntori, sepse po të varej vetëm nga koha as dhjetori nuk është aspak më i mirë, e për të nuk ankohet askush.

Por nëse mendoj edhe pak më thellë, vështirë mund të them i bindur qind për qind se kishte filluar në nëntor. Atëbotë vetëm kishte shpërthyer, kishte dalë në dritë, ishte parë menjëherë, por këtë e di tani kur shikoj mbrapa, e me siguri kishte filluar shumë kohë më parë, në të kaluarën. Ndoshta nuk kishte filluar as vitin e kaluar, por atëherë kur më kishte lindur Simoni, sepse kjo është një nga ato pikat e thyerjes, apo atëherë kur u dashuruam me Majën, edhe kjo mund ta kishte nxitur çështjen. Se, ky kombinim ishte fatal, gjë që më dukej plotësisht e besueshme, më mirë të them, është e besueshme, ndonëse edhe përkundër gjithë kësaj nuk dëshiroj të mendoj lidhur me këtë. Do të ishte më mirë, sikur të kishte filluar me lindjen time, apo edhe më parë. Që unë të mos isha shkaktar i kësaj, por as Maja, gjë që dukej si OK., e për këtë arsye të dy nuk do të ndiheshim aspak fajtorë dhe me siguri diçka ka këtu, që gjërat përcillen brez pas brezi. Të kishte filluar, për shembull, me rastin e lindjes së nënës sime, apo ndoshta edhe të nënës së nënës, apo edhe stër, stër, stërgjyshes. Atje diku në pikën e kapërcimit në mes të bujkrobërve dhe feudalizmit, apo ndoshta edhe më parë. Atëherë kur

kërpudhat e para kishin mbirë mbi tokë dhe kishin shpërthyer si orkidetë dhe prej tyre ishte zhvilluar çudia e gjithsejtë, pasi ato kishin prodhuar aq shumë oksigjen saqë të shpërthenin dinozaurët dhe bishat e tjera. Mund të jetë se kjo kishte ndodhur në fillim të fillimit, ndoshta është ky fati, apo diç e ngjashme. Është e mundur se kishte filluar mu në fillim, me rastin e shpërthimit të materies. Bum dhe që nga ai moment e tutje të gjitha pse-për arsye se-pse-për arsye se, shikoheshin në mënyrë mekanike. Po të mos ishin zhvilluar gjërat pikërisht ashtu siç kishte ndodhur dhe aspak ndryshe, as për një gram në të majtë apo në të djathtë, por pikërisht ashtu, unë nuk do të ekzistoj, dhe po të mos isha unë as kjo gjendje e poshtër nuk do të ekzistonte, sepse çdo pasojë duhet të ketë shkakun e vet dhe çdo shkak është pasojë e diçkaje dhe ky fërkim shkak - pasojë në marshin mbrapa, të çon drejt në parafillim të së keqes. Sa më shumë të gërmosh dhe të pyesësh kur, dreqi e marrtë, ka ndodhur, kur ka filluar të ecë mbrapshtë puna dhe sa më shumë ta mundosh kokën që si ka mundësi të jesh aq i verbër dhe asgjë më shumë, kjo do të thotë se nuk ka aspak kuptim të konstatosh se kur kishte filluar dhe cili ishte faktori i të gjitha këtyre.

Në rastin më të mirë e përcaktoi momentin qysh kur gjithçka ka filluar të rrjedhë mbrapsht, apo momentin kur gjërat po ecin keq. Faktet tregojnë se ishte nëntori kur kishim marrë banesën në qira.

Ndonëse këtë e di tani, kur shikoj mbrapa, por atëherë nuk e dija. E kjo do të thotë se as kjo nuk ka asnjë farë kuptimi.

Pra, binte shi, sepse ishte nëntor dhe kuptohej. Zbritëm me radhë, agjenti i pronave të patundshme, pastaj Maja e pas tyre edhe unë nëpër shkallët rrëshqitëse në përdhesen e ulët ku ndodhej njëfarë bodrumi, gjegjësisht shporet i për ngrohje qendrore, megjithëse këtë atëbotë nuk e njihja. Më vonë, kur ndodhi mbrapshtia, konkretisht Maja shkoi në komunë, që të vërtetonte se si qëndrojnë punët ndërsa unë ruajta vogëlushin. Një plakë ishte ulur në katakombet ndërmjet rafteve me dosje dhe nxori në shesh banesën tonë të marrë në qira:

- Por, ju nuk do të guxonit të banonit atje. Atje është lokali për ngrohje qendrore.

- E, ç'ka tani, - i tha Maja, - që banojmë aty.

- Nuk e di, - tha ajo, - nuk do të guxonit.

Simoni flinte në makinë dhe atje e lamë. Vetëm në makinë e zinte gjumi, përndryshe nuk flinte. Njëherë e llogarita se vënia e tij në gjumë na kushtonte përafërsisht pesë euro. Dy herë rrugës që shkonte rreth e për qark Lublanës, diku afro pesëdhjetë kilometra, madje, nëse lëvizja ngadalë kushtonte sa për tetëdhjetë. Këtë do ta bëja domosdo edhe po të mos ishte fjala për benzinën, sepse kur e vë në gjumë fëmijën duke e shëtitur me makinë, problem është koha e jo shpejtësia. Po të kisha mundësi do të sillësja

rreth Lublanës me gjashtëdhjetë kilometra në orë, por do t'i çmendja të gjithë shoferët tjerë, e në veçanti shoferët e kamionëve. Edhe kështu më jepnin shenjë me drita që të largohesha. Duhet marrë parasysh edhe fakti se treguesi dridhej në tetëdhjetë kilometra, në fakt ne lëviznim me shtatëdhjetë në orë dhe kjo nuk ishte shpejtësi e madhe. Më pas m'u prish siguresa në armaturë dhe treguesi, kuptohet, nuk lëvizte më, edhe pse dridhej përsëri, por kësaj radhe në shpejtësinë zero, megjithëse deri atëherë e kisha mendjen për të lëvizur përafërsisht me shpejtësi tetëdhjetë kilometra. Ishte e qartë se këtë nuk do t'ia lejonim më vetes, se një fjetje e tillë do të na kushtonte njëqind e pesëdhjetë euro në muaj. Dhe kur e llogarita u rrëqetha. Po kjo më kushton më shumë se kopshti i fëmijës, ku fiton edhe mëngjesin, edhe paradrekën edhe drekën edhe një ushqim tjetër, por edhe ushtrimet e vallëzimit...

Mirë, këtë duhet ta paguash plus, ashtu si edhe anglishten, qëndrimin treditësh në fshat, skijimet dhe të tjera. Në fakt, i paguan të gjitha përpos ushqimit dhe kujdesit.

- Kjo është e tëra, - tha agjenti i pasurive të patundshme, - banesë tredhomëshe. Banesë e ndriçuar, me hapësirë, e para së gjithash me çmim të volitshëm.

Ecte pas nesh dhe llo motiste, ndërkohë që ne shikonim ato pesëdhjetë metra katrorë të tredhomëshe. Nuk ishte as aq e ndritshme, këtë e dija dhe realisht e vura re menjëherë si njeri i ushtruar i artit pamor.

Kështu llambën do ta mbanim të ndezur pjesën më të madhe të ditës, por megjithatë nuk thashë asgjë, sepse nuk do të ishte më e ndriçuar nëse do ta thosha.

“... jo, se vërtetë nuk i mungonte asgjë...”

Kuzhina me këndin e ushqimit dhe me dhomën e ditës ishin të gjitha bashkë, që, sipas një logjike, do të duhej të përbënin një dhomë e gjysmë, ndonëse në shikim të parë dukej si një dhomë. Aneksi, nevojtorja me banjë dhe një dhomë tjetër, që nuk ishte një dhomë e plotë, e që kishte vetëm nëntë metra katrorë, ndonëse do të duhej të ishte së paku dhjetë. Këtë e zbulova më vonë, gjegjësisht kur filloi Maja ta hulumtojë çështjen. Atëbotë këtë nuk e dija e ai edhe më vonë llototiste për banesën tredhomëshe.

“... një e gjysmë dhe një gjysmë tjetër dhe një tjetër janë tri... dhe të gjitha këto vetëm për treqind euro në muaj. Qira të tillë nuk do të mund të gjeni askund në rrethinë të Lublanës. Në Shishka, në Bezhigrad..., gjithandej kjo kushton pesëqind. Madje edhe në Fuzhina.”

Kjo ishte e vërtetë, këtu nuk gënjente, sepse ne kishim parë gjithandej dhe këtë e dija. Madje as në Fuzhina nuk kishte. Atje, në fakt, shkova së pari, sepse mendoja se te njerëzit nga jugu do të ishte më lirë. Por nuk kishte asnjë ndryshim, përpos asaj që banesat ishin shumë të vjetruara, para së gjithash parketi. Ndoshta këtë as nuk do ta shihja, sepse s’para ua vë veshin detajeve nëse nuk kam informata. Këtë

e vura re sepse njëherë ndihmova një mjeshtër për të rrafshuar dhe për të lyer me llak një parket, aq sa tërë javën më dhembti koka prej atij helmi. Njerëzit nga Fuzhina e shtrojnë tapetin përmbi parket, kështu që nën të krijohet lagështi që shtohet vazhdimisht nga ajri, nga sarmat dhe nga ecja me çorape, pra nga të gjitha anët dhe në një moment të caktuar tapeti nuk mund të tërheqë më dhe shkatërrohet, prandaj dërrasat e parketit duhen ndërruar, sepse nuk ka më kuptim as t'i lëmosh dhe as t'i lyesh me llak.

“E di, biro, zakonisht të gjithë janë të mençur dhe thonë se mund të bëhet, por nuk mundet”, shpjegonte mjeshtri i dërrasave të parketit, ia kam harruar emrin, por më kujtohet se as një sekondë nuk e vuri maskën derisa e leu me llak dhe me siguri ishte rast i veçantë mjekësor që ishte ende gjallë. Në dorë mbante një dërrasë të gërryer, si një zog të ngordhur: “Shikoje këtë, kjo është e kalbur tejpërtej, - tha dhe ma futi nën hundë, - nëse është e kalbur tejpërtej nuk mundesh, s'ke ç't'i bësh, nuk mund ta lëmosh, sepse shqyhen qoshet, është bërë si gomë dhe llaku nuk ngjitet në të... E sheh...” E mora në dorë vetëm që të më linte të qetë.

“Aha, vërtet.”

Vërtet ishte e lagshtë, kjo ndihej.

“Këtë nuk mund ta lëmosh, biro, sepse...” e kështu me radhë.

Me të durova vetëm dy ditë. Ditën e tretë filloi të thoshte se ai do t'i priste me sharrë motorike disa

dërrasa që mungojnë për në qoshe, përmbi të cilat, ashtu e kështu, do të vendoset kuzhina dhe që ishte krejtësisht njësoj. Unë do t'i mbaja, e ai bum-brum. Edhe tani po e shoh. Mirë, disa ia arrijnë, ndoshta do të mund ta merrte atë copë dërrase diç më të madhe sesa kutia e Rubikut dhe do ta përpunonte. Ndoshta kjo ishte praktika, sepse kur shkon në *Luna Park*, në ndonjë rrotë të llahtarshme, që sillet me një shpejtësi marramendëse, të duket edhe ty se kjo nuk është gjë krejtësisht e mençur, por e beson, futesh në të, zakonisht nuk vjell, gjegjësisht nuk fluturon në gjithësi me të, apo nëse i nënshtrohesh operacionit të kushedi sejtë, për shembull, të gurëve në veshka dhe profesori në të bardha të shpjegon se si do t'i nxjerrë gurët nëpër zgurdhë dhe se nuk ke pse të frikohesh, sepse kjo edhe sot bëhet ashtu, ti thua okej dhe e ngre zgurdhën, mirëpo derisa pashë holcerin, ndoshta edhe do t'ia mbaja dërrasën, po të mos vija re se në një rën dorë kishte vetëm tre gishta, pra në dorën e majtë, por po ashtu edhe në të djathtë, e aq më tepër njëri nga këta tre gishtat e dorës së djathtë ishte i palëvizshëm, i drunjte, i shtrembëruar në një rën anë në kënd mjaft të çuditshëm.

- Më falni... - thashë, dhe e largova dorën.
- Pse po frikohesh?
- Më falni..., nuk e di...
- Pse po frikohesh? - dhe e ktheu në drejtimin tim.
- Jo, unë këtë nuk do ta bëj...

- E, pse po frikohesh?

Dhe nuk e bëra. Plaku u zhgënjye, e kapi vetë me dy gishta të dorës së majtë, e pastaj filloi ta shkepte pjesën e tepërt dhe deri në drekë nuk foli më me mua. Pastaj ika. Herët a vonë do ta provoja përsëri, kjo shihej.

Për këtë arsye tani më së pari e vështrova parketin. Copat e bukura të mëdha të dërrasës së bardhë. Panjë, apo diçka e ngjashme. E gjeta edhe një shtupë metalike, në formë rrethi, në një qoshe, por nuk desha të pyesja pse ishte aty, sepse në fund të fundit banesën nuk e blinim, e në fakt mendoja se as nuk do ta merrnim me qira. E çka do t'i bëhej, mendova. Çka do të prishej më shumë për një gjysmë viti, sepse, nëse vetëm e merr në qira, për ty është njësoj, nëse shkon diçka për së mbrapshti ti largohesh dhe nuk të dhemb për asgjë. Sa më përket mua mund të ishte edhe çep buzëçepi. Vetëm të mos bëhej momentalisht farë katastrofe, të mos ishin probleme akute. Ashtu e ashtu shikoja vetëm sa për t'u marrë me diçka, që Maja të mendonte se vërtet diçka po bëja, se po e studioja këtë. Dhe mendoja: vërtet ishte panjë apo diçka tjetër dhe reflektoja si një njeri mjaft i mençur dhe i kujdesshëm. Pastaj çepat i zbulova edhe në qoshet e të gjitha dhomave tjera.

- Ky është prej panje, apo jo? - dhe rraha me këmbë dyshemenë.

- Oh, nuk kuptoj shumë nga parketi, - tha dhe filloi të shkrepë me sy, si ti kishte rënë diçka në sy, - por

e di, këtë vërtet e di, se ishte ndër më të shtrenjtët. E shihni se është si i ri? Dhe është parket, jo laminat.

Panjë, me siguri.

Shkuam në banjë, e shtruar me pllaka nga më të shtrenjtat, italiane, me ngjyrë të papërcaktuar, diçka në mes të ngjyrës së përhimët dhe të kafes, të mira për pastrim, të këqija për nga dukja si vetë mëkati mortar dhe përfunduar në dhomën e pritjes, pranë tryezës me ngjyrë të njëjtë si dyshemeja. Për pak thashë edhe kjo panjë, por nuk e thashë, sepse do të dukej se po luaja me të, ndonëse mendova vërtet se ishte panjë. Qëndronim aty dhe flisnim, unë më së paku isha ç'kyçur plotësisht. Pastaj Maja pyeti në fund për qiranë dhe ai e përsëriti çmimin. Ndërsa Maja, po, hëm, okej, dhe a nuk mundet pak më lirë...

- E kuptoni zonjë, askund për aq para... Madje për faktin se duhet të paguani përpara më së paku për një gjysmë viti, sepse është tepër lirë, ky është kusht. Këtë e dija, se ma kishte thënë përpara, para pasqyrës, dhe kështu na përgatiti, përndryshe do të na binte të fikët. Çfarë loje ishte kjo, gjashtë muaj parapagesë. Për dy muaj edhe mund të kuptohet. Po të isha unë pranë telefonit do t'ia thosha, por ishte Maja dhe ajo vazhdoi bisedën. Tundte kokën dhe po, po. E në fund tha se do të dëgjohemi.

- Por, këto janë gati dy mijë, - thashë kur më tregoi se si dhe në çfarë kushtesh; madje parapagesë njëherësh. Ai është i çmendur?

- Diç më pak, dhe vërtet nuk ishte krejtësisht e thjeshtë, por e paguan një herë dhe je krejtësisht i qetë, nuk të pengon më gjatë drekës.

- ... dhe kur je duke pshurrur.

- ... dhe ke mjaft hapësirë të marrish frymë pas tryezës sate.

Mirë, kjo ishte e vërtetë, por unë mendova se ai po luante. Ku t'i marrim ne dy mijë euro dhe mendova se kjo nuk do bëhet. Pas dy ditësh e thirri edhe njëherë për ta parë dhe shkuam përsëri. Në Jama, ashtu quhet, Jama, në rrethinën e Lublanës, në fshat. "Në lokacion, të thuash elitist, ku nuk arrin zhurma e qytetit dhe bla, bla, bla."

Harroi të tregonte se atje nuk vinte as autobusi urban. Sepse ky fshat ishte në tokën e askujt. Qyteti për Viatorin përfundon në Gunclje, pastaj është edhe Stanezhiçe, diku afër dy kilometra më tutje, e pastaj vjen Jama edhe nja një kilometër prej këtu nuk ka asnjë pikë ndalimi autobusi deri në Medvode. Këtë e kuptova më vonë kur na u prish edhe motori i fshesave të xhamave në makinën *Hunday* dhe binte shi, e mua m'u desh të shkoja në këmbë. *Mercedesi* për një kohë të mirë ishte në pushim. Mirë, atëbotë edhe arritëm dhe thashë të shkojmë që të mos më thoshte ajo se i duhej gjithçka ta bënte vetëm, se nuk angazhohesha për asgjë, ndonëse edhe ashtu më dukej e pakuptimtë, pasi nuk kishim.

Simoni flinte ende kur u nisëm. Makina ndezi me të parën. E parkova në vendparkimin e mbuluar,

ndonëse ishte shënuar me numra, por, në djall të shkojë, binte shi, e nuk doja të më lageshin kabllot.

- E ku do t'i marrësh paratë?

- I mora hua nga njerëzit e mi. Muaj për muaj do t'ua kthejmë, kështu që është krejt e njëjtë edhe pse duhet t'i japim përpara.

- Bukur, - dhe mendoja që nuk do të më marrin për një dështak të mjaftueshëm, por nuk fola, e çka të thosha.

“U mërzita me faktin se nuk kisha kah të sillesha në banesë, pastaj nevojtorja, ku nuk kam as pasqyrë, as sqoll...”

Nja pesë minuta më numëroi se çka e kishte mërzitur. Unë heshta se nuk kisha vullnet për ngatërresë, por meqë këto gjëra ishin të vërteta edhe mua ngadalë filluan të më ngriheshin nervat dhe për këtë arsye as që mendoja për to.

Dy

Heshta dhe nuk thashë se më duhej një hapësirë më e madhe. Në atë gropë në Moste, ku banonim para se të kalonim në Jama, nuk mund të punoja, se nuk kisha mundësi të vendosja tryezën time. Aty nuk kishte hapësirë për tryezë normale, por vetëm për një tryezë të vogël që qëndronte ndërmjet shtratit dhe ormanin dhe çdo herë më duhej ta largoja. Nëse dëshiroja të shkoja në shtrat, e shtyja kah dollapi dhe anasjelltas. Nëse, për shembull të duheshin çorapet e pastra, nuk kishe mundësi të sillеше pa e zhvendosur tryezën, përpos nëse ishe një fakir hindus prej gome apo artiste cirku ruse, që me siguri do t'ia dilnin. Apo, për shembull Barbapapa, ndërsa njeriu normal jo. Tyezë ime e punës jashtë në korridor, sikur ende nuk ishin vendosur sendet, apo sikur do ta linim aty para dere, aty ku ishin mbeturinat, por kjo zgjati shumë dhe çdo njeri normal do ta kuptonte se nuk bëhej gjë me të. Gjoja se nuk kishim ku ta vendosnim. Mirëpo, në thelb, unë e kisha krejtësisht njësoj, deri

në atë moment, por tani e kisha fituar atë punë dhe më nevojitej tryeza.

Trokita, por nuk ndodhi gjë. Prita pak dhe trokita përsëri, por edhe më tutje asgjë dhe hyra sepse në derë ishte i shënuar emri i tij. Në dhomë nuk ishte askush. Dukej se kjo ishte zyra e sekretares, e cila kishte dalë diku, nuk e di se ku, në zyrën tjetër, gjegjësisht në atë përtej, të drejtorit, ku dëgjohej diçka dhe trokita edhe atje.

- Po, - murmuriti dikush dhe vazhdoi, - përpara. E hapa derën dhe brenda pashë një njeri që nënvizonte diçka në letër, që e kishte zënë me bërryl të dorës tjetër, në të cilën mbante bananen.

- Mirëdita, - thashë dhe shtova se jam Jani Bevk...

- Aaaa, ju jeni!

E futi bananen në gojë deri në fund, sepse banania rritet nga ajo pjesë me të cilën e mbajmë në dorë, nga bishti, apo çfarëdo të jetë ajo, kur e zhveshim. Si majmuni, thoshte Simoni, kur dëshironte t'ia zhvishja bananen, por jo krejtësisht, që kur ta hante ta mbante nga bishti, si majmuni, se kështu e kishte parë në një film vizatimor. Kur ishte në gjendje jo të mirë, donte t'ia zhvishja krejtësisht, e pastaj më qortonte për veprimin: "Si majmuni, doja si majmuni!" Një rast më nervozoi aq sa bananen e futa prapë në lëvore dhe e qepa me gjilpërë dhe me pe. Djaloshi shikoi, shikoi, ndali të qarin nga çudia, pastaj tha: "Vrimat, nuk i doja vrimat..." I tillë ishte kur e kishte ditën e

keqe, apo të them më mirë kur e kishte momentin e keq, se gjendja e tij mund të ndërronte në sekondë, mirëpo nëse ngrihej me këmbën e majtë, e gjithë dita i kalonte ashtu. Pra nëse i vinte gjumë mund ta merrje me mend një gjë të tillë. Kjo më shkoi ndër mend kur burri pas tryezës e futi bananen në gojë, por kjo nuk ishte më e keqja; më turbulloi.

- Do të thotë, ju jeni ai, - përsëriti dhe e futi mbetjen e bananes në gojë dhe, pardon, mlac, pardon, e gëlltiti bananen dhe i fshiu duart me pecetë letre.

- Uluni, uluni, do të pini diçka?

Thashë se nuk ishte nevoja, por ai u ngrit në këmbë dhe bërtiti ndërmjet dyerve: Majda, Majdaaaa, aq sa prej diku u paraqit sekretarja dhe murmuriti e turbulluar si t' i isha futur ndërmjet këmbëve, me siguri ishte ajo që më kishte thirrur një ditë më parë, kur m' u paraqit një numër i panjohur dhe mendova ç' të bëja: ta merrja telefonin apo jo. Numrat e panjohur nuk janë aq tërheqës. Njerëzit, zakonisht nuk të thërrasin për të të dhënë diçka, por kur u paraqita kureshtja ngadhënjeu.

- Mirëdita, zoti Jani Bevk?

- Po, - thashë dhe mendova çfarë idiotësie është kjo dhe se vërtet nuk duhesha të isha paraqitur, por kur të thonë emrin dhe mbiemrin tënd, kjo nuk është shenjë e mirë, në rastin më të mirë mund të jetë policia, apo dikush që nuk ia ke realizuar pagesën për kopshtin e fëmijës, për bibliotekën apo për gjëra të ngjashme.

Mirëpo, të tillët nuk të drejtohen me zotëri, kështu që ndoshta edhe nuk ishte gjë e keqe.

Mund të ishte nëna e tij, kjo sekretarja, nëna e drejtorit po mendoj, dhe ishte aty që nga koha e socializmit, si zot. Shumica prej tyre në këto kohët e reja do të mundohej t'i largonte dhe t'i fuste në ndonjë sektor tjetër, atje ku as vetë satana nuk do të mund ta gjente, në ndonjë bodrum për të rregulluar raftet, për të zhvendosur dosjet...

- Kafe, ndoshta?

Njëherë në shkollën e mesme, së bashku me kolegun, kishim shkuar në praktikën e detyrueshme në komunë dhe na kishin futur në bodrum, në arkiv. Atje punonte një tip për të cilin të dy mendonim se ka ndonjë lidhje gjaku me Adolfin. I kishte flokët e ndarë, mustaqet pikërisht të tilla, monovariant, siç i kishte edhe vetë Hitleri, pastaj ishte i zbehtë si gëlqere. Edhe moshën e kishte të përshtatshme, si të ishte ai apo vëllai i tij më i vjetër, dhe lëvizte si lugat. Në moment paraqitej pas teje dhe me gisht tregonte se çka do të duhej të punoja. Këtë dosje vendose atje, atë nxirre diku jashtë, apo hidhe në mbeturina. Nëse thoshte diçka, nuk mund ta kuptoje. Po të ishte gjallë do të ishte diku rreth të njëqindave, me siguri.

- Dëshironi kafe?

Prita që të merreshin vesh. Njeriun me banane, me siguri, kjo nuk e pengoi, nuk iu duk asgjë e gabuar që ndonjë teze e vjetër dhe jo ndonjë femër me minifund

dhe me kostum dhe e parfumuar, së cilës i dukej vija e zogut, e që i dinte së paku pesë gjuhë të huaja, dhe që vizitorët ta pyesnin a kenë gjë me të, sepse ajo ishte më e mirë, më e kuptueshme, sesa fakti që ta kishte sekretaren që nga koha e komunizmit dhe që mban akoma furçën e Karl Marksit. Në atë rast është krejtësisht njësoj, çka kishte tezja jote, për shembull. Ishte krejtësisht e mundshme, sepse ai nuk mendonte ashtu, e shikonte si sekretare që i zhvendos letrat, apo ngre telefonin, bën kafe dhe se nuk kishte rëndësi as fakti se mua më kishte zënë paniku dhe më rrëshqitnin mendimet.

- Kafë?, - tha edhe një herë dhe m'u duk e çuditshme që po e përsëriste, e në fund e kuptova.

- Ah, pardon. Pardon, mendova se nuk ishte për mua.

- E për kë tjetër, pra?

- Paj, ... mirë, atëherë po... Një kafe turke, nëse mundet.

- Një kafe turke, Majda, dhe mua një ujë.

Natyrisht, tha Majda dhe shkoi.

- Pra ju jeni ai, - konstatoi, e unë nuk e pata të qartë se kush do të duhej të isha. Majda më tha vetëm të paraqitem këtu, pasi bëhet fjalë për një punë, e më shumë se kaq nuk dinte. Unë i thashë se do të vija.

- ... autori i *Pufucusit*.

Dhe m'u qartësua, autori i sejtë isha. Dikur i kisha punuar disa gjëra, madje edhe ilustrime për libra për

fëmijë, kështu që mendova se bëhej fjalë për diç të tillë, e jo për stripin. Kur të thërrasin nga një shtëpi serioze botuese, e pret një gjë të tillë. *Pofucusin* e kisha vizatuar tre vjet e tre muaj më parë. Kjo më kujtohej, sepse fill pas këtij kishte lindur Simoni dhe nuk kisha vizatuar asnjë strip tjetër, dhe edhe për këtë mendoja se e njihnin vetëm kolegët e mi dhe askush tjetër. Më duket se dritën e kishin parë vetëm nja njëqind kopje, plus nja njëzet, për shembull, sa duhej të ndalej makineria. Thash, po, unë jam ai, i çuditur, sepse vërtet isha unë.

- Para pak kohësh në stripotekë gjeta një kopje nëpër raftë, - tha ai. - “Gati më ra pika nga të qeshurit.”

Edhe një he-he-he, kështu që edhe unë qesha, ndonëse *Pofucusi* nuk ishte menduar si njëfarë stripi. Dëshiroja që t’ua neveriste punën, që t’i ofendonte, por një gjë të tillë sot ishte vështirë të arrihej.

Komunistja Majda e solli kafënë e zezë, të ëmbël, e mua nuk më pëlqen sheqeri në kafe. Në fakt, më pëlqen me pak sheqer sesa me qumësht kafeja, se prej qumështit më kthehet lukthi mbrapsht. Sheqeri i shumtë ia prish shijen kafesë, disi e tëhollon, nuk e di, nuk e di pse njerëzve u pëlqen kafja e tillë. Së paku ma dha një mundësi që të bëja diçka me duar dhe me falënderim e kapa filxhanin e ëmbëlsuar të kafesë dhe prita të më tregonte se për çka bëhej fjalë.

- Është kafeja e mirë?

- Po, super, - thashë, dhe po në atë moment u zemërova pse duhej të thosha se ishte super. A nuk

do të mjaftonte vetëm një po. Mirëpo kështu ndodh kur gjendesh i papërgatitur dhe të rrëshqet fjala. Pastaj filloi të fliste dhe unë provova që ta përcillja, por ishte e vështirë, nëse në tru ende të silleshin bananet dhe zogu dhe andej-këndeje, kafja me sheqer, por prapëseprapë e kuptova se shtëpia e tyre botuese diçka krijonte, njëfarë edicioni apo diç të tillë, pasi dëshironin të botonin edhe gjëra të tjera, e jo vetëm ato që i kishin botuar deri më tani, diçka krejtësisht ndryshe, e unë thashë aha, sepse përsëri ai u ndal.

- Dikur krijoja muzikë punk, - filloi më vonë dhe më pyeti nëse e kisha përcjellë ndonjëherë?

- Juve?

- Jo mua, punkun?

I thashë se e kisha përcjellë, ndonëse isha paksa i vonuar për gjëra të tilla, pasi kisha ardhur në këtë botë më vonë, në kohën e Majkut dhe Motorheadëve, kohë që i përket rokenrolit e më përpara Boney M, por kjo ishte atëherë kur isha krejtësisht i vogël dhe ata e kishin publikuar *Nightfly to Venus*. Nëse më kujtohet mirë, atëbotë ekzistonte edhe punk¹-u, por atëherë unë isha qurravec dhe më shumë më pëlqente *Brown girls in the ring, sha-la-la-la-la*, pastaj *By the rivers of Babylon, where we sat down ...* e gjëra të ngjashme. Edhe Pankrtat² dhe Dead Kennedys, sepse

¹ Punk - Muzikë rroku në vitet '80 në Amerikë, por edhe filozofi jetësore.

² Pankrtat - Grup muzikor i kohës në Lublanë.

ata i njihja me emër! Ai foli edhe diçka tjetër për punkun dhe gjëra të tilla dhe për punën e tij, dhe unë gjerbja kafenë dhe shikoja se si humbej dhe çka do të ndodhte më vonë, e njëkohësisht provoja ta përcjellja.

- Ç'është me rëndësi, tani jam këtu, që një kohë, në fakt dhe jam lodhur paksa, të jem... i civilizuar, të them ashtu.

- Aha...

Dhe që tani kjo alter shtëpi botuese, që është ide e tij, do të duhej të merrej me produksionin e gjithsejtë, pra edhe me produksionin e stripave, qofshin edhe të fëlliqtë. Diversione të vogla provokuese, të cilave po u vinte sërish koha. Ashtu diçka. Dhe unë e piva kafenë. Më mbeti vetëm gota e ujit, edhe pse kafenë mund ta pish ngadalë, pikë nga një pikë, unë vura buzët në skajin e filxhanit dhe sfrk, sfrk, sfrk e piva, ndërsa ujin nuk mund ta pish ashtu. Në fakt, edhe ujin mund ta pish pak nga pak, por prapëseprapë ai mbarohet më shpejt... Eins, cvej, drej, dhe ja, shkoi.

- Dhe do të dëshiroja... pra... atë stripin tënd... atë Pofocusin tënd... një libër, një strip... një performancë, një lojë me kitarë... por edhe si shtojcë për ndonjë gazetë. Nëse do të zhvillohej diçka nga kjo, mirë. E nëse jo, jo.

Një pauzë. Dhe u mbarua edhe uji. Çka dëshironte? Stripin?

E hapi sirtarin, nxori prej tij një libër të ilustruar dhe e ktheu kah unë që ta shoh. Bëhej fjalë për Martin

Kërpanin. Pastaj heshti, heshta edhe unë, sepse mendova se do të duhej të vazhdonte ai, por ai nuk vazhdoi dhe prandaj m'u desh të pyesja...

- Çka... Nuk po ju kuptoj?

- Mendova, për shembull, ta ilustroja Martin Kërpanin.

- Nuk po ju kuptoj, - thashë. - Çka të bëj... Në fakt si ta ilustroj? A nuk është i ilustruar?

- Shikojeni këtë, lexojeni dhe ilustrojeni ashtu siç mendoni se është më mirë, me ngjyra.

E mora librin në dorë, e shikova pak, e shfletova dhe aty ku Kërpani e nxjerr kalin nga hendeku dhe i hipur mbi të vjen deri në Vjenën e zbrazët dhe gjithandej me flamuj të zinj. Pastaj thyen armët, gjuan disa shigjeta, pastaj pret drutë, ndërsa njëfarë plake, perandoresha, nëse kujtohem mirë, vë duart në kokë Këto gjëra i dija unë, por dhe gjithkush.

- Nuk ka nevojë të jenë motivet e njëjta, ndonëse ndoshta do të ishte mirë, pasi janë motive të njohura dhe të pranuara, apo ndoshta edhe jo. Paramendojeni se në vend të Kërpanit, nuk e di, atje të vijë ndonjë personazhi juaj që i rregullon gjërat sipas vullnetit të vet. Por nuk dëshiroj t'ju sugjeroj gjë. Ashtu si t'ju pëlqejë juve.

Thashë, aha, ndonëse nuk e pata krejtësisht të qartë si ta ilustroja. Mendoj, e kisha të qartë përafërsisht si do të dukej heroi im dhe çka do të bënte në atë libër, por nuk e dija a është ajo që mendonte ai. Pofucusi

im do ta nxirrte pelën nga hendeku, por nuk do ta nxirrte me duar dhe tani nuk e dija, a do ta publikonte ndokush atë, se unë Pofucusin e vjetër e kisha punuar vetëm për lojëra, për kolegët... - Mirëpo, thashë, dhe kur e thashë këtë nuk dija ç'të thosha më tutje dhe heshta në mënyrë që të vazhdonte ai, por ai nuk vazhdoi dhe m'u desh mua të vazhdoja: - Mirëpo, sa *hard core* mund të jetë kjo?

- Nuk e di...

Nuk e di? A ta punoj si... në atë strip? Në djall shkoftë, më vinte turp të thosha si në Pofucus, ndonëse unë vetë e kisha vizatuar. "Aq sa më kujtohet, mendoj... në atë mënyrë?"

- Mendoni, a u duhet të kurseni diçka?

- Po, - thashë, - po për kë është kjo?

- Jo, jo, nuk duhet... nëse mendoni se duhet pikërisht ashtu...

Mendova lidhur me atë që më tha, por ende nuk e dija saktësisht se çka dëshironte.

- Unë nuk e di. Ju po e porositni, - thashë.

- As unë nuk e di. Do të shohim. Varësisht nga ju dhe nga ata atje poshtë, - dhe tregoi me dorë diku poshtë. Pashë në drejtim të dorës së tij dhe nuk e pata krejtësisht të qartë. Atje poshtë nuk ishte asgjë e veçantë. Rruga si rrugë, me kioskën, para së cilës prisnin dy vetë. Nuk di çka prisnin, prisnin për cigare apo prisnin Dellon...

- Për shembull po ta vizatoni se si Kërpani bën dashuri me princeshën, apo diçka të ngjashme, - dhe

atë *bën dashuri* e theksoi sa që u bë e qartë se po bënte shaka, - dhe këtë e shpërndajmë në librari, çka mendoni se do të ndodhte?

- Nuk e di, - thashë.

- Martin Kërpanin... e Levstikut..., slloven? Martin Kërpanin, për shembull, që e pallon, - tani e theksoi fjalën *pallon* princeshën, apo mos e thëntë Zoti, vetë shkëlqesinë e saj - mbretëreshën?

Rrudha supet.

- E shihni, pra, as unë nuk e di.

- Aha...

- Po.

Pastaj heshtëm disa sekonda.

- Por, mos të të lodhë kjo. Unë jam rrufepritësi. Nëse duhet dikush ta bëjë, do ta bëj unë... Ç'mund t'u ndodhë juve? Keni punë shumë kohët e fundit?

- Jo aq shumë, - thashë. - Se kam fëmijën, e kjo...

Ky idioti e dinte se vërtet nuk po punoja gjë.

Tre

Rrugës për në shtëpi mendoja sesi do ta vizatoja këtë, se askurrë në jetë nuk kisha vizatuar kuaj, se nuk janë aq të thjeshtë t'i vizatosh, e veçanërisht kur janë në lëvizje. Po të ishte e thjeshtë, Da Vinçi nuk do të lodhej me ditë të tëra me ta dhe nuk do t'i grimconte, t'i shpërndante gilcat dhe zorrët nëpër tryezë, vetëm për ta kuptuar sesi dhe çka kanë. Pra ta bëja tani unë një gjë të tillë nuk do të ishte në rregull, ndërsa nga *horse-burgeri*¹ nuk mund të kuptohet sesi ishte dikur kali në vrapim.

Në përgjithësi me kafshët është problem. Njëherë, në kohën para Simonit, me Majën u gjetëm në stacionin hekurudhor në Hamburg dhe unë desha t'i çlodhja këmbët para se të nisesha dhe kështu fillova të sillem vërdallë, ndërkohë që arrita në Kunsthalle, që ishte krejt afër. Brenda ishte një student receptionist, që më lejoi të hyja pa paguar dhe të shikoja pak.

¹ Horse-burgeri - Burger me mish kali.

Fillimisht u ktheva për Majën, por tha se nuk kishte vullnet për një gjë të tillë, gjë që ishte e keqe për të, e unë isha i mendimit se do të mund të vinte, ngase unë veç kisha shkuar atje dhe isha kthyer, por okej. Qëlloi koha që aty ishte ekspozita e Francis Baconit, njeriut të çuditshëm irlandez, që bënte portrete të shëmtuara prej të cilëve njëri kishte marrë pjesë në Dylan Dog dhe për këtë shkak fillova të interesohesha për të. Edhe ai ishte aty, me gojë vesh më vesh. Mendova sa të çuditshme janë ato rrugë. Atje ishin fotografitë, portretet e tij dhe mjedisi i tij i punës, pra, ai dhe atelieja e tij. Lokalin për dru e kishte të shtruar ashtu, tryeza dhe dysheme të mbuluara me furça dhe me gjithfarë gjërash, pra, vendi im i punës, do të thotë tryeza ime, në krahasim me të tijën, ishte krejtësisht sterile. Sipas kësaj dukej se kishte probleme të mëdha, do të thosha. Dy decimetra humus, ngjyra, si dhe furça prej qimes së derrit. Por, atje në katin e dytë të muzeut ruheshin edhe disa piktura të Cezannit, a disa sosh, për shkak të së cilave e quajtën koloristi më i mirë në botë, ndonëse askurrë nuk e pranuan në Akademinë Franceze, ishin pjesë të një përmbledhjeje të përherëshme. Retë, detin dhe natyrën, në përgjithësi i kishte të bukura, fine. Ndoshta qëndrova gjysmë ore para njëres prej tyre; deti, gjiri, retë dhe ndonjë varkë, nëse më kujtohet si duhet, sepse më interesonin ngjyrat. Më vonë një grua m'u drejtua në gjermanisht gjoja, a po më pëlqente, e pasi e kuptova se ç'më

tha, ia ktheva: po, më pëlqen. Më tha se i pëlqente edhe asaj dhe se ishte tepër e bukur. *Vundershen* apo *vunderbar*, ashtu më duket. Në Kunsthalle ka një pikturë të Cezannit me dimensione pesë herë katër metra, në të cilën dy zonja të kohës së atëhershme kalërojnë, në një perspektivë disi të çuditshme. Me vullnetin tim më të mirë nuk do të mund të thosha se kjo është kjo. E mbajnë aty vetëm se është e tij. Në fakt është mirë që e kanë, sepse duket, por dhe ndikon në mënyrë qetësuese, nëse merret ashtu, sepse edhe më të mirëve u ndodh kjo, e unë me siguri nuk do t'i lëshoja nga dora kuajt të vizatuar aq keq.

Çështja me kuaj paksa më mundonte, por, le të jetë. Te Martin Kërpani nuk vraponin shumë, sepse ndoshta atëherë kur kishin dyluftime, atje po, por edhe bëhej fjalë për një *slow-motion*¹ dhe tani për ta vizatuar kalin statik nuk nevojitet asnjë lloj shkence. Logjikisht sepse lëviz pak më dobët, e veçanërisht nëse pranë ka sllovenin. Më shkoi në mendje menjëherë se as i imi nuk do të jetë i tillë. Që të vrapojë si njeriu merimangë, por fill pas kësaj kali i tij do të duhej të fluturonte. Me rroba dhe me armë, pra me shpatë dhe me armë të ngjashme besoj se nuk do ta kisha problem, sepse në muzeun kombëtar të dielave të para në muaj hyrja është falas dhe atje i kanë..., por mirë, këto janë vetëm disa detaje. Në fund të fundit

¹ Slow-motion - Lëvizje e ngadalësuar, veçanërisht në film.

këto gjëra i kanë vizatuar edhe para meje dhe mund t'i kopjoj e t'i fus në ndonjë kontekst tjetër, askush nuk do të ma marrë për të keq.

Po të jem krejtësisht i sigurtë, unë do të dija të vizatoja për bukuri çdo lloj kali e në veçanti kuajt si karikaturë të atyre që janë kuaj. Në pikë të mesnatës me brekë dhe i shtrirë me shpinë. Nuk ishte kjo. Kisha paksa frikë dhe nervat kishin filluar të më punonin, ndonëse nuk kisha filluar ende.

Vetëm kur arrita në Moste më ra ndër mend se problemi më i madh, apo së paku problemi i parë, ishte ai që nuk dija kur do të vizatoja, se kryesisht merresha me ruajtjen e fëmijës dhe nuk e dija se ku. Në kohën që nuk kisha porosi as që mendoja për një gjë të tillë. Mirëpo, as kjo nuk ishte gjë që do të mund të më pengonte. Kjo ishte pengesë tokësore, por e zgjidhshme.

Metër nuk kisha, kështu që nxora lidhësen prej atleteve dhe me të mata gjerësinë e tryezës. Ndoshta lidhësja ishte nëntëdhjetë centimetra, apo njëqind e dhjetë, pasi për atlete duhet të jenë më të gjata, por kjo nuk kishte rëndësi, meqë matjen e bëra vetëm që të shihja a mund ta fusja tryezën atje brenda, pra për krahasim, që a ishte krejtësisht njësoj, pra a ishte tryeza tetëdhjetë e shtatë, apo njëqind e shtatë centimetra. Pastaj mata edhe hapësirën ndërmjet dollapit dhe shtratit. Mund të futej, por me vështirësi dhe nëse e fusja tryezën atje do të më duhej të hipja

përmbi të për të hapur dritaren dhe ta kapërceja atë kur të doja të shkoja për të fjetur, apo kur të shkoja te djali, gjegjësisht te shtrati i tij. Pra, treqind milionë herë në ditë. E Simoni do të lëndohej gjatë zvarritjes përmbi të, ndonëse ishte i shkathtë dhe motorik dhe tip që shquhej në fizkulturë dhe në lojëra në kopshtin e fëmijëve, ku kishin një anije të tillë me shkallë e tobogan, mirëpo, Simoni kur binte në mendime, apo nëse i ngulte sytë në diçka, në moment i harronte të gjitha dhe fluturonte diku drejtpërdrejt me kokë. Njëherë, kur ishte një vit e pak më shumë, ishte ulur në qoshe të tryezës dhe përkundej e përkundej derisa në një moment e humbi drejtpeshimin dhe u përplas, më dhembë dhe me buzë drejt në qoshe të tryezës. Një copë e buzës iu çka dhe djali qau e bërtiti, por edhe gjaku i rrodhi. Ishte e tmerrshme sepse të dy u frikësuam. Pastaj vrapuam në urgjencë ku na thanë se gjithçka do të bëhet mirë, se kjo nuk ishte asgjë dhe gjaku ndërkohë kishte ndaluar, por na thanë se të nesërmen duhet të shkonim te dentisti. Shkuam, dhe dentistja - që ishte një zonjë e këndshme, që kujdesej edhe për dhëmbët tanë thoshte: “Hape gojën, hape pra gojën e vockël...” si një djaloshi të vogël dhe nuk kisha gjë kundër, se shponte aq ngadalë dhe me kujdes, aq ndjeshëm, gjatë gjithë kohës pyeste nëse po i dhembte... tha se nuk dinte se ç’do të bëhej, se dhëmbi me siguri ishte i vdekur, më së paku njëri, ndoshta edhe dy, se do t’i binin shumë shpejt, dhe

para kësaj do të merrnin ngjyrë të zezë, e se ç'do të bëhej me zhumbinën vështirë mund të thoshte gjë, por me siguri nuk do të jetë problem. Dhëmbët pas një kohë vërtet morën një ngjyrë të hirtë, por nuk ndodhi asgjë tjetër. Ende ishin në vendin e tyre edhe pas dy vjetësh nga kjo ndodhi. Njëherë tjetër në Shpar rrëshqiti nga disa lego-kuti¹ drejt me kokë dhe preu majën e hundës, që më vonë e ngjitën. Mbeti një qepje, gjegjësisht një ngjitje e vogël. Dhe së treti ishte në urgjencë kur u rrëzua nga curulaja, atëherë kur Maja - faleminderit Zotit që ishte ajo - e shtyu pak tepër dhe djaloshi u frikësua, i lëshoi duart dhe diku nga një lartësi pothuaj një metër e gjysmë u rrëzua përtokë. Nuk e di se ku ra, sepse nuk isha pranë. Vrapova në spital dhe atje dukej sikur nga koka po i dilte një alien, apo si të kishte një kokë të dyfishtë, krejtësisht të ënjtur. Çfarë problemi... Maja ishte në fund me nerva... fotografimi i parë tregoi se e kishte kafkën e plasur, por më vonë u pa se nuk ishte e vërtetë, se ato ishin plasaritjet e kafkës që janë te fëmijët më të dukshme, por përndryshe gjithçka ishte okej. Koka e dyfishtë që atë natë erdhi në vend, kështu që mund të shkonim në det, në çadrën e shoqatës së fizkulturistëve Partizan (atje ku vogëlushi shkante në fizkulturë) në Premanturë.

¹ Lego - Lloj lodre për fëmijë, në formën e tullave plastike shumëngjyrëshe, të montueshme dhe të çmontueshme për të ndërtuar objekte në miniaturë.

Kështu, pra, nuk vinte në konsideratë të vendosej kjo tryezë e madhe, ndërsa në tryezën e vogël nuk mund të punoja, pasi letra do të varej nga tryeza, e kjo do të thoshte se nuk kisha ku t'i vendosja ngjyrat, pra që përndryshe ishte tepër e ulët. Një punë në të dhe do të bëhej keq. Do të mund të punoja, për shembull diku tjetër, në ndonjë bibliotekë, për shembull, së paku skicat t'i bëja atje, por nuk e duroja dot që njerëzit të më shikonin pas shpine dhe të shihnin se çfarë fëlliqësish po vizatoja, sepse vetëm gjëra të tilla do të vizatoja. Por edhe po të mos vizatoja gjëra të tilla, nuk mund të duroja që dikush ta shikonte punimin tim pa e përfunduar. Edhe pasi ta përfundoja më pengonte. Nëse ia jepja dikujt punimin që ta shihte se çka kisha punuar dhe ai të më jepte mendimin e tij për punimin, kur edhe vinte momenti do të vinte dhe një gjë e tillë duhej të bëhej, sepse ti nuk di ç'të shtosh më, përsëri e lija atë kohë dhe dilja diku jashtë. Në nevojtoje, sikur shkoja të përshurra apo diçka ashtu. Ajo pritje është e dhimbshme. Është, nuk është, është nuk është..., dhe pse nuk buzëqesh atëherë kur sipas një logjike do të duhej të buzëqeshte dhe pse nuk i pëlqente ajo që sipas një logjike tjetër do të duhej t'i pëlqente.

Këtu s'kisha ç'të bëja. Që ta fusja brenda tryezën vetëm kur aty të mos ishte kush, që do të thotë kur Maja ta merrte Simonin, as kjo nuk ishte zgjidhje, se tryeza ishte tepër e rëndë dhe do të më duhej të kërkoja ndihmë nga dikush, meqë kjo nuk ishte një

tryezë moderne alumini, apo ndonjë prodhim nga fijet e forta sintetike, por tryezë druri, nuk e di a ishte panje, por jo, sepse ishte e errët, por ndoshta prej arre apo prej ndonjë druri edhe më të rëndë nëse ekziston, ndonjë lloj tiku apo kiku afrikan, apo çfarëdo lloj druri tjetër qoftë, që zhytet në ujë dhe me të cilin punohen skulpturat. (Dru i tillë me siguri nuk ishte, sepse nuk kishte kah të vinte tek unë). E kjo punë duhet të bëhej pesë ditë në javë, herë të vendosej brenda e herë jashtë, që do të thoshte dhjetë herë në javë dhe kjo vërtet nuk mund të bëhej. Në korridor gjithashtu nuk mund të vizatoja. Ky ishte edhe një problem tjetër.

Problemi tjetër ishte se nuk e kisha krejtësisht të qartë se çka të bëja. Maja punonte si spikere në Radio Shtudent e aty-këtu bënte edhe reklama radiofonike apo televizive, meqë kishte një zë fantastik, pastaj në ndonjë *call center*, për ato *keni thirrur këtë e këtë numër, lëreni mesazhin* dhe nuk kishte ndonjë orar të caktuar, por vraponte herë andej e herë këndeje dhe askurrë nuk e dinte saktësisht si dhe çka, sepse askurrë nuk dinte të thoshte jo. Njëherë të vetme mund të thuash jo, e pastaj nuk të thërrisnin më dhe mund të pirdhesh. Ndërkohë e merrte Simonin për një orë, apo edhe për më pak, e pastaj unë i kisha nja gjashtë orë në ditë, që do të ishte super dhe do të mjaftonte, se ashtu e ashtu askurrë nuk mund të duroja gjashtë orë në tryezë, por shumicën e rasteve e merrte nga një gjysmë ore, njëzet minuta, në mëngjes, në mbrëmje,

me kapërcime, por asnjëherë përpara nuk e dija se kur do të vazhdoja e kur jo. Në përgjithësi në mëngjes nuk kisha vullnet, pra nuk mund të funksionoja ashtu se në mëngjes më duhej të flija sepse përndryshe nuk nxirrja gjë nga vetja. Nëse flija e pastaj në qetësi e pija një çaj të gjelbër mund t'ia filloja punës. Kjo ishte diku rreth orës dhjetë, ndoshta ndonjë minutë më vonë, por më herët assessi, kështu që as nuk ngrihesha. Së paku në jetën e përparshme ishte ashtu, por derisa Simoni nuk i largoi këto dilema, meqë ai nuk flinte as natën, e lëre më ditën. Mendoja se kopshti i fëmijës do t'i zgjidhte problemet, se atje do të mësohej të flinte, apo ndonjë gjë tjetër që nuk dija se çka, por ai u bë edhe më keq. U sëmur nga astma, gjegjësisht astma u paraqit fill, ose më mirë pasi për të gjashtëmbëdhjetën herë u sëmurë me bronkiolitit. E kur ndodh ashtu, paraqitet astma dhe ne na u desh ta nxjerrim jashtë dhe të merreshim me të gjatë ditës, gjë që nuk kishte kuptim ta mbanim në spital ku do të vraponim. Dy herë shkuam ashtu e ashtu derisa mjekja na tha ta marrim në shtëpi dhe të presim edhe nja një vit sa të bëhet për kopsht fëmijësh, që t'i forcohej sistemi imun. Mendova se nëna dhe baba do ta marrin vogëlushin, pasi nëna ishte në pension, po ashtu edhe baba fill para lindjes së tij, ashtu siç më kishin marrë mua prindërit e tyre, pra gjyshi dhe gjyshja ime e Lublanës; më kujtohet shtëpia dhe kopshti tjetër, që ne nuk e kishim provuar kur isha i sëmurë apo në pushime, por gjyshja ime

ishite një gjeneratë më e çuditshme sesa nëna ime që mendonte se te gjenerata e saj kjo gjë duhet ndërprerë, apo, nuk e di çka. Nëna ime e ruante Simonin vetëm atëherë kur isha unë pranë, por këtë nuk do ta quaja ruajtje, por vizitë. E të shkoja tek ta, sepse ata nuk mund të vinin tek unë dhe t'i dëgjoja vërejtjet si:

- E, kur do të fillojë të ecë?

Një vjet e kishte mbushur.

- Nuk e di. Do të ecë kur të ecë.

- Tani do të duhej të fillonte. Fëmija i Anës ka filluar. Të kujtohet Ana?

- Jo, - thosha.

- Nuk e njeh Anën? Si ka mundësi?

Dhe më tregonte gjithçka për Anën, ndonëse edhe pasi e përfundonte ligjëratën nuk e kisha më të qartë se kush ishte ajo dhe ç'kisha të bëja unë me të.

Dhe kështu me radhë. Pastaj, një ditë prej ditësh u ngatërruam aq shumë, gjegjësisht kur doja t'i thosha Simonit të shkonim, meqë nëna po priste, e të largoheshim pa pasoja më të rënda. Sikur në derë mos ta dëgjoja...

- Aq sa e ruajta unë këtë fëmijë nuk e ruajti askush.

- Çka the? - m'u shkëput fjala.

Nuk ishte gjithçka në rregull me të dhe këtë ia thashë sepse pas netëve që kisha kaluar pa gjumë, për shkak të veshëve të sëmurë dhe dhëmbëve e astmës, si dhe për gjërat e tjera të zakonshme me fëmijën dhe që vërtet dëshiroja të punoja, erdhi deri aty sa dëshiroja

të bëja çfarëdo qoftë, por nuk mundja. Se askush nuk u gjet që ta merrte qoftë edhe për një minutë të dhjerë, e pastaj ajo:

- Sa bëra unë nuk bëri asnjëra.

Po dreqi ta marrë, gjithçka ta marrë. Ishte më 15 gusht para dy vitesh. Më kujtohet saktësisht pasi ishte Ngjitja e Zojës në qiell dhe atëherë kjo ishte një festë e re dhe unë me Simonin shkuam vetëm për faktin se tha që do të ishte bukur ta kalojmë festën të bashkuar si familje. Automatikisht thashë po, do të vijmë, sa për ta qetësuar, dhe kur arritëm atje, fillova të mendoj se çfarë feste ishte kjo, e pas kësaj një vit nuk u dëgjuaam më.

Kështu, nuk kisha kohë, por edhe po të kisha kohë, duhej edhe ta vendosja tryezën brenda. Dhe nuk vizatoja. Dhe isha i zemëruar me veten dhe në tërë botën për këtë gjë, pasi më duhej të punoja edhe gjëra të tjera për të sjellë para në shtëpi. Me gjithçka u mora, që nga shitësi i tiketave në stacionin rrugor deri te mbledhja e boronicave, por këtë nuk e bëra gjatë, pasi sllovakët ishin më të shkathtë dhe më të shpejtë dhe se e paguanin një euro, e mua nuk më dukej gjë një euro. Ky ishte ai problemi i tretë. Derisa fillova të më dukej një euro njësoj si ata.

Por atë ditë ishte Maja e lirë dhe më shikonte, ndërsa po e zgjidhja rebusin me lidhëse dhe Simoni vraponte pas meje dhe bërtiste.

- Babi, do të ndihmoj unë, - dhe ma merrte lidhësen nga duart për të cilën me siguri në ndonjë

rast tjetër do të zemërohesha, se Maja do të duhej ta merrte me vete, por kësaj radhe nuk ndodhi se isha hepi për shkak të Martin Kërpanit, ndonëse ngjante kjo idiotësi me kohën dhe hapësirën.

- Po, si shkoi puna? - pyeti Maja kur erdha në shtëpi pa ia filluar të merrem me lidhësen dhe ia shpjegova prej a-së deri në te zh-ja. Ia thashë edhe atë se nuk e dija saktësisht çka priste ai nga unë dhe se kisha frikë se do të vizatoja diçka që nuk do t'i pëlqente, e nëse do të ndodhte kjo, atëherë do të ishte keq, e nëse jo, do të jetë e keqe se nuk do të më pëlqente mua.

- Pse nuk e pyete?

Ja, e dita. Por, nuk dëshiroja të kisha konflikt me të, se jeta ishte tejet e përdhosur për një gjë të tillë, që të ngatërrohesha me të në këtë ditë me diell. Në vend të kësaj e përqafova, e putha në ballë dhe i thashë se e dua shumë dhe të mos e prishte, pasi do të shkonin diku jashtë, qoftë edhe në shëtitje, sepse para nuk kishim as për bukë. Se do të punoja një pikturë të vetme, do t'ia tregoja dhe se do të shohim se çka dhe si do të ndodhë.

- Nuk do të ishte mirë të të refuzonte, mendoj për shkak të mundimit tënd.

- E pyeta, - thashë, - variantin porno të Martin Kërpanit e do, nëse e kam kuptuar mirë. Dhe do ta fitojë. Por të mos ankohet më vonë. E putha në ballë. "Të dua Maja." Pastaj në vesh, ndërkohë që ende ishte në përqaftimin tim.

- Edhe unë ty, për këtë arsye edhe po them, - tha.

Mendonte se për gjëra të tilla mund të merreshim vesh. Ti pyet, ai të tregon. Për shembull vizatoje këtë e këtë dhe ti e vizaton dhe kjo është okej... Por jo, se pastaj ai do ta shikojë këtë dhe “po, në rregull është, por nuk e kërkoja këtë”, por nuk është problemi aty se nuk e kërkoj atë. Pikërisht ajo gjë është, por mund të mos i pëlqejë dhe ti mund të pirdhesh. Kështu që, në fakt, nuk ka kuptim ta pyesësh. Ashtu e ashtu gjithçka mbetet mbi ty.

Në mbrëmje e nxora Pofucusin. Maja dhe Simoni flinin njëri pranë tjetrit në shtratin e madh. Nuk desha ta zgjoja që ta çonte në shtratin e tij të vogël se do të rrezikojta të më kalonte vullneti, por me bateri në dorë i shikoja sirtarët derisa e gjeta. Njëqind herë kisha thënë se duhej ta rregulloja përmbledhjen time, t’i vendosja në një vend të gjitha punimet, por këtë nuk e kisha bërë. Një pjesë të mirë të origjinaleve i kisha humbur dhe me secilin që kisha humbur kishte humbur edhe një pjesë e vullnetit tim për t’i rregulluar. E veçanërisht që kohëve të fundit nuk kisha ç’të bëja. Mirëpo Pofucusin e gjeta dhe me bateri në dorë u ula ta lexoja.

Mund të ishte veprim depresiv kjo retrospektiva e vetvetes. Askurrë nuk isha i kënaqur. E veçanërisht fill pasi përfundoja ndonjë vizatim, më dukej se vizatimi ishte një mut i vërtetë. Çdo vizatim të dështuar e njihja deri në detaje, secilën vizë apo

pikë dhe nuk mund ta krijoja menjëherë në kokë një pikturë të duhur. Shumë gabime, një përmbledhje e plotë e gabimeve të dhjera. Gjithçka gabimisht, me dhunë, pa farë kuptimi. Mua gjithmonë më dukej dita më e keqe ajo ditë kur më duhej të dorëzoja ndonjë punim për të cilin kisha marrëveshje për pagesë. Fillimisht për faktin se pas gjithë atyre shkarravitjeve dhe përmirësimeve më dukej i kotë, e së dyti edhe për faktin se ata e kishin një lloj parashikimi të vetin, që mua më dukej pa kuptim. E vizatoja, e dorëzoja, kopjen time e fusja diku dhe nëse ruhej në rregull mirë, nëse jo, jo. Mirëpo, po ta kisha edhe një ditë të vetme, me siguri do të dukej krejtësisht ndryshe. Këtë thosha gjithmonë. Pofucusin as që e kisha shikuar që nga koha e publikimit dhe më kishte ngërthyer një dilemë, ndonëse isha ulur vetëm, por prapëseprapë. Atëbotë kur e vizatova e ndieja veten si supermen dhe si Picasso, jo gjithmonë, por kur isha pikërisht në atë *filig*, kur nuk më dukej se jam dështak i thjeshtë dhe i paaftë, por kështu ishte. Kush je nuk mund ta dish derisa ta provosh, kjo është tragjedia. Po të ishte ndryshe, këtë do ta thoshte dikush dhe po t'i besojë me siguri do të kurseje shumëçka.

Dhe ia fillova. Vizatimi i parë në të cilin Pofucusi tridhjetëvjeçar paralajmëron tregimin e vet. Një lloj tregimi në suaza. I lehtë. Dhe nuk ishte vështirë. Vizatimi ishte në rregull. Teksti rridhte. E lexova faqen e parë. Kjo më shkante tepër shpejt, tërë stripin e kalon

në moment. Maja askurrë nuk mund ta kuptonte sesi e arrija këtë. Ajo zakonisht vinte deri në faqen e tretë të Dlyan Dogut, ndërkohë që unë isha në pallosjen e tij të fundit, atje kur ai në fund, vazhën që kishte ardhur për vizitë, me problemet e veta thelbësore e shpëton dhe e kënaq me melankolinë e vet dhe me një pallosje të thellë filozofike nën çarçafët me të cilët ishin mbuluar deri në gjysmë. Dlyan Dogu ishte stripi im më tërheqës nga të gjithë stripat e popullarizuar. Fillimisht pak kriminalitet mbinatyror, pastaj pallosje. Te stripat e mi unë gjërat i ktheja paksa, pasi ky as që ishte zhanër i njëjtë. Më shumë më pëlqente ta kisha si Jeremanjën e Hermanbit, të jem krejtësisht i sinqertë, ndonëse njeriu këtë nuk mund ta pranonte me zë të lartë. As atë dhe as faktin se dëgjonte Boney M-në.

Pra, Pofucusi kryesisht shpjegonte me disa vizatime, sesi i lexonte përrallat kur ishte i vogël dhe sesi i adhuronte në përralla princeshat që i ruanin himenet për princërit e tyre dhe kishte vendosur që edhe ai do të jetë i tillë kur të rritet, ndonëse kjo nuk ndodhi, pra nuk kishte fat. Nuk ishte i bukur, por kishte edhe mangësi të tjera. Ishte i munduar dhe i stërmunduar, ndërsa princeshat palloseshin atje me gjithfarë majmunësh. Me lloje të ndryshme të njerëzve të çuditshëm, duke filluar me kurvarë e deri te njerëzit e dështuar, që në dallim prej tij së paku dinin të ishin të mërzitshëm, gjë që ai nuk dinte dhe brenda tij filloi të grumbullohej inati derisa një ditë prej ditësh ia

arriti. Njëra prej tyre, që përmbi vete kishte kaluar gjithçka, erdhi edhe deri tek ai. E zhgënjyer dhe duke menduar se ai do të ishte i mirë dhe se nuk do të ishte si të tjerët. I qau në supe, princesha e lodhur, ia pranoi të gjitha, se ti nuk je i tillë, ti je i mirë, ti je më në fund më i mirë se të gjithë tarzanët e rremë, që ma kanë futur, dhe kjo është okej, ti do t'i kuptosh të gjitha. I tregoi deri në detaje sesi e kishte ngrënë dhe prej kujt, sepse mendonte që tani do të fitonte duartrokitje për sinqeritetin, por atë e zemëronte edhe më shumë, edhe pse kishte nevojë, ç'të bësh, dhe hipi mbi të, i zemëruar aq sa filloi të shpejtonte. Dhe, shih çudinë më të madhe. Në mes të pallosjes, në fakt më shumë kah fundi i pallosjes, aty diku para ngërçeve paraorgazmike, kur gjithnjë e më shumë i dilnin para sysh me detaje ish-pallosësit e saj, njeriut, Pofucusit, organi i rritej në mënyrë enorme. E vizatova sesi vajza i kishte zgurdulluar sytë, fillimisht me një befasi të këndshme, e pastaj me një rrëqethje gjithnjë e më të madhe derisa nuk u shkatërroua përmbi organin, ashtu si pëlçet tullumbacja e fryrë shumë që, le të themi ishte e mbushur me gjak. Mbetet vetëm lëvozhga dhe një njollë e përgjakur.

Lexoja ngadalë, për dallim, figurë pas figure dhe nuk ishte asgjë e keqe, rridhte bukur, bashkë me tekstin, kuptohet, sado që ishte ashtu si ishte. Në fakt ishte në rregull, aq mirë saqë, si për një barsoletë, fillova të qeshja dhe qesha aq sa nuk dita të ndaloja

dhe thashë se kjo kishte pasur sukses të madh, e në të njëjtin sekondë e kuptova se autori isha unë dhe qesha edhe më shumë, aq sa e zgjova Majën që ishte në një gjumë aq të rëndë sa u frikësova se do të zgjoja edhe djalin. Asgjë, thashë dhe i tregova Pofucusin, ndërsa ajo më kërkoi ta ndihmoja për ta çuar Simonin në shtrat. E ngrita dhe e kalova në shtratin e tij. Diçka murmuriti dhe foli, por nuk u zgjua. Pastaj me Majën bëmë seks dhe paksa më vinte të qeshja ende për shkak të Pofucusit dhe fatit të tij. Mirëpo, edhe kjo ishte në rregull dhe interesante ishte që më bëri të ndieja nevojën për leximin e stripit tim.

Katër

Kisha kohë që nuk llogotisja më lidhur me faktin se shpërnguljet janë një imtësi dhe vetëm merrja çantën dhe shkoja, sepse nuk ishin të tilla. Këtë e thua kur je qurravec dhe nisësh nga nëna diku për pesë minuta, e pastaj kthehesh aty përsëri në drekë. E në tryezë të pret supa e ngrohtë me grimca me mish lope, njëfarë njolle e tillë si një rrjet merimange, pastaj një rreth karote dhe pak patate, mishi dhe sallata. Në raste të tilla shpërnguljet janë sa për sy e faqe, përndryshe jo, përndryshe janë problem, problem që çdo vit bëhet më i madh. E veçanërisht nëse ke fëmijë. Kështu fillon ta mbushësh bagazhin dhe mendon se një herë a dy dhe do të kryhet, por e mbush njëherë, e jashtë mbetet edhe një grumbull i madh i gjërave, kurse në banesë edhe njëherë aq dhe fillon të mendosh ç'dreqin është në ato kutia, sepse as ti vetë nuk e di. Prej këtyre gjërave përdor vetëm një pjesë të vogël, një kuti, për shembull, ku janë brekët, xhinsit, brekët e brendshme, disa kanotiere, një xhup, pulovër dhe

xhaketë me kapele, nëse është dimër, e nëse jo as këto nuk të duhen dhe kaq. Pastaj brushën e dhëmbëve, pastën dhe zhiletin, pastën për rroje, por këtë ashtu e ashtu e përdor vetëm një herë në muaj kur fillonte të të kruhej mjekra dhe të duket vetja si rrugaç. Pra, këto gjëra janë të tuat prej të gjitha atyre të tjerave, pastaj disa gjëra të përbashkëta, disa tenxhere dhe gjërat e Simonit, e këso ka më së shumti. Mbeten gjërat të tjera, por këto janë shumica. Njëherë, gjatë një shpërnguljeje në prag para dere, lashë një kuti kartoni me diçka. Nuk kisha vullnet ta rregulloja, kështu që mbeti aty derisa dikush e mori. Nuk kam idenë se çka kishte brenda dhe askurrë nuk më mungoi gjë. Ndoshta ishin këto stripat e mi, që më vonë nuk i gjeta, por nuk e besoj. Me siguri ishte diçka nga kategoria nuk dihet se çka, që i bashkon si miu, prej zoti di prej kah. Mund të ishin gjëra nga fëmijëria jote, pasi e kuptoja se Simoni kishte të njëjtin refleks si unë që të mos hedhë asgjë, dhe unë i kisha gjithmonë xhepat përplot me guralecë, me lule apo me ndonjë imtësi tjetër, dhe nuk guxoja të humbisja gjë, qoftë dhe rastësisht, se ai nuk kishte vullnet t'i merrte me vete. Njëherë më dha gjashtë guralecë t'ia ruaja, se ai me ta do të... nuk di më se ç'do të bënte, por njëri prej tyre ra në tokë dhe nuk desha ta merrja; ku do ta dinte fëmija se njëri prej tyre do të mungonte. Ai nuk dinte të numëronte deri në gjashtë, por jo! Ueee, ueee m'u desh të kthehesha dhe ta gjeja pikërisht atë guralec, që m'u duk krejtësisht

si të tjerët, por atij jo, për të ishte i posaçëm dhe duhej ta sillja në shtëpi, ku më vonë vërtet harroi dhe mund t'i hidhja në mbeturina. Por, këtë do ta bëje vetëm pas tri ditësh, kur isha i sigurt se nuk do të kujtohej më. Kur je më i vjetër duket se ndodhin gjëra të njëjta. Nëse fillon t'i hapësh kutitë dhe fillon të shohësh për të hedhur gjërat që nuk të nevojiten, pikërisht atëherë nuk do të hedhësh asgjë. Je më i rritur dhe e di se këta janë ata guralecët e tu dhe se është gjynah t'i tretësh. Sepse, pas nja shtatë vjetësh do të duhen për diçka e pastaj nervozohesh dhe shan. Për këtë arsye nuk i doja shpërnguljet.

Pastaj, blerja e këpucëve, rrobave dhe gjërave të tilla, ndonëse këto nuk janë edhe aq të vështira sa shpërnguljet.

Hunday ynë e ka bagazhin mjaft të madh, gjë që ishte njëra nga cilësitë e tij, ndonëse ishte makinë koreane dhe dukej se e kishin montuar në ndonjë film vizatimor japonez të harakirit. Nuk do ta blinin sikur Maja të mos turfullonte pasi solla në shtëpi një *mercedes* të vjetër, tridhjetëvjeçar. E fitova gati falas dhe vërtet ishte paksa i vjetër dhe me ngjyrë kafë, madje edhe i kalbur. Këto gjëra shiheshin, por me siguri mund të rregulloheshin se motori ishte në rregull. Dhe tash, këtë ma thanë edhe kolegët e mi të mençur, duhet ta pastroja, ta mbushja me kit, ta ngjyroja dhe do të vozitnim me *Mercedes*. Mua nuk më lodhte fakti që të blija një makinë monotone,

për shembull, farë pesëshi, mundësisht të bardhë, se makinë të tillë ka gjithkush e nuk do të duhej ta kisha edhe unë, apo *Hundayn*.

E solla në shtëpi, atëherë Simoni ende nuk kishte lindur, ia shpjegova Majës se si do të pastrohen dhe do të rregullohen këto gjëra dhe ajo vetëm të zgjidhte ngjyrën. I thashë se prapëseprapë ishte diesel dhe e madhe dhe në aspektin ergonomik i sigurt, por ishte oldtajmer dhe kursente gjatë regjistrimit, por ajo vendosi për një ngjyrë bordo të kuqe, ndërsa unë mendoja për të kaltrën metalike, por le të jetë. Brendësia le të jetë e bardhë, për këtë ramë dakord që të dy, kështu që të voziteshim rreth e rreth si Jovanka me Brozin, por kjo nuk ndodhi, pasi atëbotë nuk kishim para, e as më vonë. Pastaj u bë problem se këtë makinë e mbante në një copë vetëm shtrati i merimangës dhe ngjitësi apo çfarëdo qoftë, sepse teneqe praktikisht nuk kishte. Dhe kur me kolegun tim, si njohës të automobilave, e ngritëm tepihun përpara, nën frena, por vetëm pas një kohe, kur erdhëm në shtëpi kërpudha u ngrit përjetë. Kërpudhë, dreqi ta marrë, një kërpudhë e bardhë e tejdukshme. Kuptohet nuk kishte dritë, nuk ishte kërpudhë e tillë, por vërtetë ishte kërpudhë. Si me sustë, pong! Ç'është kjo, plako, çka kisha blerë unë? Mirëpo, paratë veç i kisha dhënë. Ç'të bëja? Për njëqind e pesëdhjetë mijë, se atëbotë i kishim tollarët, që vërtet nuk ishin farë parash, por një yugo në gjendje të vozitshme

do ta fitoja për këto para. Një yugo të tillë që do ta vozitesha së paku edhe pesëdhjetë mijë kilometra para se ta lija diku në rrugë. Më vonë e kuptova se si ishte puna me oldtajmerët. Ti duhet të ishe mekanik që ta mbaje. Pastaj duhej ta kishe garazhin që të mos mashtrohesh. Përndryshe krejt kohën duhej të punoje diçka në motor, që të ishe për së mbari, pastaj ta fërkoje, ta pastroje, ta përmirësoje teneqen, e në veçanti nëse teneqja ishte aq e kalbur dhe gjëra të tilla. Dhe duhej të shkoje në Itali, apo në varrezat e automjeteve dhe atje të kërkoje gjithfarë copash, por as kjo nuk kishte kuptim nëse një makinë e tillë nuk ka as çati mbi kokë, pasi shumë shpejt shndërrohej në një patundshmëri. Natyrisht, unë që nuk kuptoja gjë nga makinat dhe nuk kisha para për të vrapuar nga servisi në servis për t'i porositur pjesët origjinale për dizel dyqindësh të 1974-ës, që të shëtisja nëpër Rakova Jelsha, apo nëpër Cesta dveh cesarjev dhe të keqtrajtohesh, ndonëse as vullnet nuk kisha, sepse nuk dija se çka do të më shisnin atje, edhe pse kishim ardhur në këtë gjendje. Kur ma vodhën edhe shenjën e *Mercedesit*, atë të vjetrën në bazament, e jo një yll i ngjitur rakitik, siç janë sot, u demoralizova plotësisht. Në fakt nuk u nervozova, se edhe unë si tinejxher vidhja shenja të tilla, kështu që ndoshta bëhej fjalë për një lojë fati, për karma, apo... E ç'është *Mercedesi* pa shenjë. Në Moste ishim tre që i bënim këto gjëra, se njëri prej nesh lexonte një lloj libri, gjegjësisht

librin e lexoja unë, ku qurravecët bërin gjëra të tilla dhe për këtë arsye edhe ne i ruanim në një shtëpizë në kopsht. E kishim një përmbledhje të bukur, kështu që ato më të zakonshmet dhe ato që hiqeshin më së lehti, për shembull nga Volkswageni, që vetëm me diçka duhej ta ngrije w e dyfishtë e ajo dilte jashtë, ato as që na interesonin. Vetëm shenjat pak më të përdreqshme dhe të rralla, siç ishin për shembull ato të moskviçit, që ishin nga xhami, të punuara në një kornizë masive teneqeje, që duhej ta prishnim plotësisht për ta nxjerrë xhamin prej saj. Nëse më kujtohet mirë, shenja e tij ishte një anije e bardhë me prapavijë të kuqe, por ndoshta edhe gaboje, ndoshta ishte kjo Lada e jo moskviçi, por e di se sigurisht ishte e futur në kornizë metalike, sepse më kujtohet një rast kur e nxorëm krejt maskën e përparshme plastike, sepse ndryshe nuk mund të vinim deri te shenja. Sot do të ishin edhe më të rralla sepse moskviça nuk ka më. As Lada. Dhe kështu, erdhëm një ditë dhe nuk e gjetëm as shtëpizën e as gjërat brenda saj, se e kishin lëruar kopshtin dhe kishin filluar të ndërtonin një bllok. Që nga ky rast ndalua, se nuk patëm më vullnet, humbja ishte tepër e madhe. Ashtu ndodhi edhe me limuzinën tonë. Vetëm tatëpjetën e morëm me të, se kabllot pas çdo shiu ngopeshim ne ujë, dhe motori nuk ndizej. Fillimisht në monsunet e gjata, e më vonë edhe në rastet e shiut të zakonshëm slloven, e në fund edhe atëherë kur vetëm një re afrohej diku pranë. Kabllot i izolova me shirit,

por pa sukses; dukej se lagështia u kishte hyrë brenda. Duhet të prisja të dilte dielli, pastaj kolegun për t'i huazuar kabllot ndezës për të vazhduar ecjen. Pastaj na duhej ta përcillnim paralajmërimin e kohës dhe kur paralajmërohej kohë e ngrohtë dhe e thatë ishim të lëvizshëm, përndryshe me autobus. Pas një kohe na ndodhte çdo herë gjatë shpërnguljeve të shpeshta. Si ta zhvendosnim *Mercedesin* e papërdorshëm dhe në këto raste mendoja Borutin, që t'i binte kabllot dhe të më tërhiqte. Diku rreth ndërrimit të njëzetetretë të vendbanimit të paparalajmëruar të përhershëm Maja u mërzit me këtë dhe bleu makinën *Hunday accent* me ngjyrë të gjelbër të mbyllur. Verës në të ishte aq nxehtë sa nuk mund të durohej, por këtë nuk mund ta dinte, sepse makinën e bleu në dhjetor. Përndryshe punonte nëse përjashtojmë disa imtësi, siç ishin siguresat, që herë pas here digjeshin, apo dritat dhe motori për pastruesin e xhamave. Këto mund t'i rregulloja unë, por në shumicën e rasteve nuk e bëja, kështu që ndodhi si me *Mercedesin*. Po të binte shi ishte problem, ndryshe mund të lëvizje, mirëpo, nëse binte shi i madh më duhej t'i hapja dritaret dhe ta nxirrja kokën jashtë, por me kohë as kjo nuk ishte e mundur se u prish mekanizmi për ngritjen e xhamit dhe u bë problem edhe në ditët me diell, për shembull në stacionet rrugore të pagesës, kur të duhet të paguash, pastaj në vende parkimi ose në vende të ngjashme. Por ndodhi që edhe kabllot në *Hunday*, kur ishte lagështi, filluan nga problemet.

“Merre Simonin dhe shkoni të shëtisni diku për një dy orë, e unë do t’i bëj të gjitha grumbull, pastaj do të ndërrohem dhe ti shëtis deri atje”, më tha Maja që e dinte se si e ndieja veten, por me djalin tonë gjërat ishin edhe më djallëzore, sepse sillej nëpër këmbë dhe dëshironte të ndihmonte, e kjo nuk bëhej.

“Ku do të shkojmë, vogëlush?”, e pyeta dhe shpresova se do të thoshte në RRKSH, pra në Rrugën e Kujtimeve dhe të Shoqërisë, pasi atje ishte një rrugë e gjerë, e shtruar me zall, pastaj një rrafshinë përreth dhe pemë, tetëdhjetë e tetë blinjtë për Shokun Tito dhe për vdekjen e tij, kështu që atje nuk mund të rrëzohej askund dhe as të binte me kokë, vetëm se mund të shkelte në ndonjë mut qeni, e në anën tjetër unë mund të shëtisja pranë dhe të mos mendoja asgjë, mirëpo, kuptohet, nuk deshi aty.

“Në Mostec, babi, shkojmë në Mostec.”

Dhe shkuam se, në fund të fundit, unë vetë e pyeta për dëshirën dhe le të bëhej sipas dëshirës së tij. Okej, ai ende nuk dinte as ta fshinte vetë prapanicën, në fakt asgjë nuk dinte të bënte vetë, por dinte të fuste në gojë gjithçka dhe të bëhej pis, kështu që ishte më mirë t’ia fusja unë sendet në gojë, madje po të duhej t’ia përtypja, por si mund të mësohej fëmija kështu. Kuptohet se këtë nuk e bëja, por rrija pranë duke pritur si tigri buzë përroit, nëse rastësisht i binte gjë nga goja, unë ia merrja, para se t’i bënte pislleqet e tij, më vonë edhe këto i lashë, sepse ishte njësoj si ta bëja ose

të mos e bëja. Vetëm kur ishim në ndonjë restorant, apo në ndonjë vend publik, kisha kujdes që të mos na nxirrnin jashtë, madje ashtu e ashtu nuk shkonim askund. Kjo ngjante ndoshta një herë në treqind vjet dhe nuk ishte problem. E pasi e pyeta nuk shkuam në RRKSH, por shkuam në Mostec. Atje ishte krejt tjetër sepse kishte lodra, toboganë dhe curulaja, por kishte edhe tren metalik ku mund të hipësh, por ishte i lartë nja dy metra, e prej tij mund të rrëzoheshe përtokë në zall dhe këtë zall mund ta hante, pastaj ishte edhe një përroskë me brigje të pjerrëta dhe gurët mund t'i gjuash në të, si dhe gjëra të këqija për prindërit. Veçanërisht të dielave, aty ishte edhe treni elektrik, që me 1 euro shëtisje pesë minuta, bëje disa xhiro, me të cilin vogëlushi ishte i pasionuar dhe kështu paratë shkonin aq sa të mëshiron edhe zoti, sepse një shëtitje nuk ishte asgjë, dhe shumë shpejt u mësua me të, pasi i thosha se nuk kemi më para. “Apo”, thoshte dhe vraponte drejt trenit nga gypat metalikë, të lartë dy metra, që nuk lëvizte hiç, e që vërtet më vinte keq që nuk kishim më para. Kështu që kërkoja se mos në xhepa më ndodhej ndonjë euro tjetër, por vërtet nuk kisha. Ndërkohë, lazdranat e tjera shtriheshin përtokë derisa prindërit ua paguanin nga pesë shëtitje, që të pushonin pak, e unë, në anën tjetër, edhe isha i gëzuar që nuk kisha, sepse, zoti e di se edhe mua do të më ndodhte e njëjta gjë.

Pra, nëse e pyet duhet edhe ta respektosh. Nuk mund të qëndroje në mes të rrugës dhe të thoshe okej,

po bisedoja me të dhe kjo ishte e tëra që bëja, në fund të fundit ç' dinte ai. Për fat të mirë nuk ishte ditë pushimi dhe Mosteci ishte gati i zbrazët, vetëm dy nëna ishin ulur me fëmijët e tyre, të dyja njerëz koti, por të kotë ishin edhe fëmijët e tyre. Madje nuk më kujtohet çka ishin, djem apo vajza.

Pastaj më duhej të shkoja pas vogëlushit prej toboganit të vogël deri tek i madhi, e te këta është problemi se e shoqëroja deri në majë të shkallëve e pastaj vrap deri në fund, atje ku tobogani i gjuante fëmijët, e atje e shikoja vogëlushin dhe bërtisja:

“Jo ende, Simon, prit vetëm pak, jo ende.”

E pastaj deri te curulajat që silleshin në rreth e që të duhej t'i shtyje, e ajo rënkonte se pesëqind vjet nuk i kishte lyer askush. Çdo rreth në vendin pikërisht të njëjtë. Dukej se vogëlushit kjo i pëlqente më shumë, e unë te çdo skviii ndieja sikur dikush më gjuante me gurë në kokë, skviii, skviii, skviii..., pastaj krejt repertori, e prej aty mbrapa edhe një herë deri te guralecët në ujë, dhe edhe një herë, në mes të kënaqësisë më të madhe nuk dëshironte më, e unë krejtësisht i rraskapitur shikoja orën dhe konstatoja se kishin kaluar vetëm dyzet minuta dhe se kishte mbetur edhe një orë e njëzet minuta. Atëbotë nuk të mbeste gjë tjetër, por të shkoja në kafene për akulllore dhe të rrija me të në bankë, afër pensionistëve që luanin shah, pra afër dy vetave, të dy kacafyteshin me birrën e tyre dhe e vrisnin kohën, ndërsa nja tre të tjerë, secili me birrë

në dorë dhe të heshtur, shikonin, askush nuk e thoshte asnjë fjalë, vetëm pasi përfundonte loja, e komentonin atë me tri fjalë e gjysmë, sikur nuk kishin vullnet më ta lëviznin gjuhën, sepse gjithçka, ashtu e ashtu ishte e vetëkuptueshme dhe se të folurit ishte marri e pastër, sepse herën e fundit kur ishte interesante të thuhej diçka ishte në majin e dyzetepesës, pastaj i ndërronin figurat dhe sërish nga zeroja. Sipas mendimit tim ata do ta mundnin Kasparovin po t'i pranonte kushtet e tyre. Të luante këtu në Mostec një shah me poteza të shpejtë, të pinte birra, të mos fliste asgjë dhe të sillej si duhej. Sigurisht që do ta mundnin. Kështu i kishe pesë minuta pauzë aq sa të duhet për të filluar rishtazi t'i bërtasësh fëmijës dhe ta përgatitje vazhdimin. Sipas meje kjo i përngjante gjysmëlojës në futboll apo në basketboll, pra lojërave të tilla me top.

Simoni dukej i bukur, ndërsa po lëpinte akulloren, me buzët përreth pis, në foto dukej si fëmijë Tibeti.

- A është e mirë akullorja?

- Po, është... - e ngriti lart dhe filloi të fliste si të belbëzonte, edhe pse nuk belbëzonte. "Me çokollatë. Provoje!"

E kafshova një copëz të akullores. Ashtu e ashtu pyeta vetëm për faktin se e dija se do të më lutej e kjo më pëlqeu.

- Kjo është akullorja më e mirë në botë, Simon, nga koçolata.

- Po të vinin kusarët e të më sulmonin, unë do t'i... do t'i... umf, - dhe akullorja ra në pluhur.

- Babi, babi... akullorja ime, akullorja ime e shkretë.

- Mos qaj, Simon, mos qaj, - thashë dhe nxora kuletën nga xhepi, do të blejmë një tjetër. Mendova vërtet t'ia blija, edhe pse i kishte rënë diku nga fundi, e në fakt nuk e meritonte akulloren tjetër, qija nënën, në kuletë kisha vetëm edhe 20 centë, e akullorja kushtonte dyzet. E tani, hajt e shpjegoja këtë Simonit.

- Akullorja ime... premtove babi, babi...

Shkova te gruaja pas banaku me vogëlushin për dore dhe ia shpjegoja çështjen.

- Edhe me kartelë mund të paguani, - tha dhe i thashë, po, faleminderit, por e kam harruar në shtëpi, ndonëse kartela ishte në kuletë, por edhe po të dija se ka gjë brenda, nuk më kujtohej kodi, se për herë të fundit e kisha përdorur në fillim të verës dhe mendoja ç'të bëja nëse nuk ma jepte, sepse Simoni i kishte sytë e përplotur dhe priste që babi t'ia blinte akulloren. Po të mos kisha premtuar do të merrte skalpin, ose do të mendonte se isha baba koti, dhe kjo ishte edhe më rrëqethëse.

- Por, për një akullorë do të keni, me siguri, - tha shtriga, që dukej se nuk ishte e keqe dhe ia dha vogëlushit një akullorë në formë iriqi, paramendoje në formë iriqi e jo të thjeshtë, pa lajthi, vetëm me çokollatë. Iu thashë se do t'ia paguaj herën tjetër. U afruam te pensionistët dhe djaloshi dy herë e lëpiu akulloren, e pastaj "babi nuk mundem më!" dhe m'u desh ta haja unë.

E dija se do të përfundonte kështu, por nuk ishte problemi i akullores, këtë e kuptoja. I dhashë të pinte ujë, t'i lante buzët që të mos i prishte dhëmbët, siç i kisha prishur unë, që isha rritur në kohën kur te ne kishte arritur çokollata “Milka” dhe të gjithë ne e hanim në vend të bukës dhe e shpëlanim me çaj të ëmbëlsuar. Një kohë llogotiti diçka me pyetjet pse bie shi, pse paraqiten vetëtimat dhe pse bie breshëri, madje edhe a i lag shiu hajnat, a jetojnë hajnat te ne dhe gjëra të tjera, e pastaj filloi të heshte dhe të shikonte diku në largësi.

Kur erdhëm në shtëpi, e zuri gjumi në karrigen e tij ende i bërë pis rreth gojës nga çokollata e unë e mbaja të qetë. Mund të paketoheshim. Na u desh të shëtisnim katër herë për ta përfunduar shpërnguljen. Shpërnguljen tonë të pesëqind e gjashtëmbëdhjetë, apo që nuk e dija as unë. Dhe sido që ta marrësh ky nuk ishte problem i thjeshtë. *Mercedesin* nuk e luajtëm vendit, sepse e pashë që Maja ishte e lodhur dhe nuk dëshiroja ta mërzijsja edhe me këtë, e edhe Boruti dhe Borisi kishin humbur diku.

Pesë

Po t'i merrja targat do të mund ta lija aty, në Moste, apo kudo tjetër, por më dhimbej. Ishte i vitit 1974, që është viti i kampionatit botëror në Gjermani, në të cilin lojtari më i mirë ishte shpallur Franz Beckenbaueri, ndërsa Brane Oblaku ishte futur në njëmbëdhjetëshen ideale. Ndonëse në fakt nuk e kujtoja këtë kampionat, sepse atëherë sapo kisha lindur. Kampionati i parë, që më kishte mbetur në mendje, ishte ai në Spanjë, tetë vjet më vonë dhe atje mbretëronte Paolo Rossi nga Italia, që ishte bërë kampione botërore, e që në finale e kishte mundur Gjermaninë me rezultatin tri me një, ndërsa golin e vetëm për gjermanët e kishte shënuar Breitneri. Kjo më kujtohej, se fill pas kampionatit shkuam në det në Zarë dhe se automobilat italianë pas xhamave të prapmë kishin rezultatin, ndërsa ata gjermanë, kuptohet jo. Po ta kishin, apo nëse e kishin automobilat gjermanë, me siguri se ishte rezultati nga gjysmëfinalja, kur në vazhdime kishin barazuar kundër Francës dhe kur Rumenigge i kishte shënuar

dy gola në shpejtësi, ndërsa Platini në penallti, *ciao, aufwiderzen*. Këto dy gjëra, për shembull, më kujtohen plotësisht, ndërsa kampionati jo, por më vonë u botua një broshurë, buletin ku ishin shpjeguar të gjitha lidhur me kampionatet botërore dhe lidhur me atë në Gjermani, e pastaj këtë broshurë e lexoja gjatë drekës, apo në nevojtoje, nëse nuk kisha stripa. I kisha disa periudha të tilla të përziera, e Maja atë kohë më shikonte e çuditur dhe pyeste si mund t'i lexoja pa ndërprerë këto gjëra, këta numra, e më vonë, kuptohet, u mërzit me pyetje.

Gjërat i bartëm shpejt nga automobili, gjegjësisht i barta unë, ndërsa Maja më vonë i palosi ato, gjë që i mori më shumë kohë. Ndërkohë unë rrija pas tryezës që ta merrja veten dhe të merrja frymë. I thashë edhe Majës që edhe ajo të ulej dhe të pushonte, por ajo nuk e bëri këtë. Unë po, mbase isha lodhur shumë dhe nuk mendoja për asgjë. Shpeshherë Maja më pyeste se si ia arrij kësaj, në përgjithësi kur kishim aq gjëra për t'i rregulluar, por pikërisht këtu ishte edhe thelbi. Gjithmonë gjendet diçka për të rregulluar, dhe kur e konstaton këtë, mund të ulesh një minutë dhe të mos mendosh lidhur me asgjë. Mirëpo, ajo këtë nuk dinte ta bënte.

E pastaj: punf dhe diçka fluturoi nëpër xhamin e paradhomës, ku kishte hapësirë veçsa për një tryezë të vogël dhe për ndonjë karrige e që kujtonte njëfarë lugu të betonit, mbi të cilën kalonte rruga ndërmjet

dy blloqeve të vogla. Sikur ndonjë Schumacher lokal të voziste shpejt nga vendi i parkimit të shtëpisë së dytë pranë shtëpisë sonë dhe po të gabonte rrugën, atëherë do të binte drejt në supë, nëse kjo ndodhte në kohë dreke. Nuk m'u dha të shihja çfarë fëlliqësish kishin ndodhur, pasi në Lublanë as që kisha dëgjuar për to. Tek automobilat, apo kamionët e tillë, apo automobilat e ndihmës së shpejtë dhe helikopterët e ndihmës së shpejtë, në Moste ku jetonim herën e fundit, si dhe të gjithë mutrat e motorizuar, që mund të ishin aty, madje edhe motokultivatorët, apo të tjerat që nuk mund t'i numëroja, ndonëse ara e parë më e afërt ishte së paku dy ditë ecje nga aty dhe këtë punf as që do ta regjistroja, por pastaj edhe një herë punf, sepse pas kësaj nuk ishte e domosdoshme të ishte rastësi, por njëfarë renditjeje.

- Çka është kjo? - tha Maja.

- Nuk e di, - thashë dhe dola të shikoja.

- Jani, - klithi sa u tremba, - bretkosat!

- Mirë, bretkosat, dreqi t'i marrë, mendova se ishin dinozaur, e jo bretkosa. Nuk mund të shtiresha se nuk ishte e rëndësishme dhe u ngrita të shihja, o nëna e Zotit, me të vërtetë ishin. Qenë grumbulluar aty jashtë para dyerve rrëshqitëse të xhamit, kërcenin njëra përmbi tjetrën dhe provonin të ngjiteshin nëpër xham. Kuptohet nuk kishin sukses, as bretkosat nuk mund të ecnin nëpër xhamin e lagshtë, rrëshqisnin dhe ky i gjuante mbrapa në grupin e të afërmeve të

tyre dhe pastaj përsëri në xham dhe mbrapa në truall. Kishte lëvizje atje jashtë.

- Ç'është kjo, ç'është kjo, ku kemi ardhur ne?

- Po, nuk mund të hyjnë brenda, - thashë, ndonëse as mua nuk më pëlqente kjo. Nuk kisha frikë nga bretkosat, logjikisht jo. E çka mund të bënin, e unë nuk doja të krijoja panik, por nuk ishte e bukur as të shiheshin në numër aq të madh. Në fund të fundit, si mund ta dëbosh bretkosën, gjegjësisht ta largosh atë? A ta kap? Krahët i ka rrëshqitës? Teorikisht do të mund t'i shkelja me çizme, apo t'i vrisja me çekiç, apo me hu, nuk do të kalonin as dhjetë minuta dhe të gjitha do të ngordhnin. Këtë nuk mund ta bëje, por vetëm nëse je vrasës potencial serial, e këtë nuk e di derisa të fitosh mundësinë për ta provuar një gjë të tillë, mirëpo unë këtë nuk do të mund ta bëja. Në njërën anë, vetë fakti se janë qenie të gjalla, që lëvizin, kërcejnë atje rreth e përqark, ushqehen me perime dhe me mushica dhe nuk e di unë me çka tjetër, pastaj bëjnë seks, të nxitura nga një fuqi e madhe, për ta e pakuptueshme, kjo ishte vetëm një çështje, e pastaj ngordhin në neveri. Më duket se nuk mund t'i keqtrajtos e të mos neveriten. Macen për shembull mundesh, mund t'ia thyesh qafën apo diçka ashtu, ndonëse unë këtë nuk do të mund ta bëja, mirëpo teorikisht do të mbeste vetëm trupi i saj i bukur në një thes të leshtë dhe në shikim të parë nuk do të ishte asgjë e tmerrshme. E tani, me bretkosën çështja është krejtësisht ndryshe,

nuk mund ta asgjësosh pa e shtypur dhe kjo bëhet me një shtrydhje të zorrëve dhe të lëkurës rrëshqitëse, të krahëve dhe syve e të gjitha këto janë aq të neveritshme. Për to ndoshta këto paraqesin njëfarë mbrojtjeje, kjo neveri pra. Ngjashëm si kombinimi i zi-verdhë që është i helmues dhe që kafshët e dinë se nuk guxojnë t'i prekin insektet, gjegjësisht grerëzat apo gjërat e tjera të ngjyrosura kështu. Nëse e kafshon bretkosën, ajo të spërkat dhe prej saj shpërthen një masë me shije të çuditshme. Njeriu është diku në gjysmë të rrugës ndërmjet maces dhe bretkosës. Lëkura e mban në një copë, por jo aq shumë dhe tani, po të hynte njëfarë brontosauri, apo për shembull njëfarë elefanti, nuk do të ishte aspak e bukur dhe për këtë arsye njeriun do ta vrisja më me vështirë se macen, por, sipas asaj logjike, më lehtë se bretkosën.

- Jani, drej, bretkosat!

- Ndoshta po shumëzohen, - thashë dhe do të largohen fill sa ta përfundojnë këtë.

Nuk jam profesionist, por e kam zbuluar se shumica prej tyre ishin në kate, njëra mbi tjetrën, e vogla lart, ndërsa e shëndosha poshtë. Ndonëse njeriu do të priste që këto gjëra t'i bënin në pranverë, e pastaj të lindin në verë, bretkosat e vogla, apo çfarëdo që lind prej tyre, por jo në vjeshtë. Ndoshta tani kanë argëtimin përshëndetës para dimri, para se të futen në baltë, a të largoheshin në jug, nuk e di. E çka dija unë për bretkosat. Ndoshta tani bëjnë seks,

pastaj gjatë dimrit ngjizen dhe në pranverë i pështyjnë ato fulterëzat, ndoshta këtu trualli është radioaktiv, kështu që bretkosat i kanë dy të korra, ashtu si delta e pëlleshme e Nilit, por atje bëhet fjalë për grurin dhe për tërfilin.

- S'kemi çka të bëjmë, duhet të presim thatësinë apo ngricën, - i thashë, që të presim ndonjë ndryshim, se ashtu e ashtu tani në hyrje nuk mund të ulemi, sepse është tepër ftohtë e ne do t'i hapim vetëm dritaret. Brenda nuk do të hyjnë sepse dritaret janë tepër të larta, vetëm nëse janë super bretkosa. Ekzistonte rreziku që të hynin në banesë nëse del të marrësh gjë jashtë, në makinë apo t'i hedhësh mbeturinat dhe ta lësh derën e hapur për shkak të bravës që mbyllet automatikisht, por kjo nuk më shkoi ndër mend.

- Por bretkosat nuk janë të rrezikshme.

Këtë e thashë që ta qetësoja atë dhe veten se vërtet ishte një mori sosh dhe nuk tingëlloi krejtësisht bindëse fjala ime. Një zog vërtet nuk është i rrezikshëm për njeriun e rritur, qoftë edhe shqiponje të jetë, as edhe dy zogj, por nëse është një grumbull sish. Me qindra apo mija, edhe po të jenë trumcakë është krejtësisht tjetër. E tani, bretkosat vërtet nuk i kanë sqepat apo dhëmbët, këto vetëm mund të përjargin deri në vdekje. Të hipin mbi ty dhe t'i lëshojnë ato jargët vdekjeprurëse. Ashtu si dinozauri në parkun Jurik, sikur atij kompjuteristit të shëndoshë t'ia spërkaste drejtpërdrejt në sy dhe t'ia shtypte kokën. Bretkosat

ulen mbi ty kur je duke fjetur, ndjeshëm si fluturat në lule dhe ti ëndërron se mbi ty ka zbritur mjegulla, por në të vërtetë ato të përjargin dhe kur të zgjohesh është fundi, je pa lëkurë dhe vetëm muskujt e organet duken prej teje dhe të merr djalli, sepse pa lëkurë nuk mund të jetosh. Dukesh si i zhveshur dhe e di se do të shuhesh dhe ke dhimbje të tmerrshme, ndërsa bretkosat vetëm rrinë mënjane dhe presin të vdesësh, në mënyrë që ta përfundojnë dalëngadalë punën e tyre. E krahas kësaj dëgjohen vetëm ato rega, rega, kvak, kvak si një flad i butë.

Kjo më kaloi nëpër kokë dhe thashë të shkoja të shoh Simonin, se e ndjeva në lukth një të përzier, në mos rastësisht ishin futur në makinë. Jashtë, edhe në shkallë ishin një mori sosh. Në fakt nuk i kishin mbuluar shkallët, por m'u desh të lodhesha që të mos shkelja ndonjërin sosh. Ku ishin përpara, djallet e gjelbra, gjegjësisht ngjyrë kafe, se të tilla kishte më shumë. Apo atëherë kur e morëm me qira këtë shtëpi bretkosash? Pakëz u larguan, por jo shumë, ndonëse nuk më dukeshin sulmuese. Dukeshin më shumë si të humbura, jo të frikësuara, por sikur të pyesnin: po ti, do të thotë unë, ç'po bëja këtu. Ashtu si Dlyan Dog që në mëngjes gjendet vetëm në planetin e tokës dhe nuk e ka aspak të qartë se çka kishte ndodhur me të tjerët dhe ku kishin vajtur.

Vogëlushi flinte ende, mirëpo kur hapa derën, pasi nuk mund ta shihja për shkak të xhamave të

mjegulluar, filloi të lëvizte dhe unë e dija se ç'do të thoshte kjo. Se do të zgjohej, ngase kishte fjetur një orë apo dy, përndryshe do të ekzistonte mundësia të flinte përsëri, e kështu jo. Prita që të shikonte dhe të fokusohet, pastaj e mora nga ulësja dhe duke kapërcyer bretkosat e futa në banesë. Fillimisht u ngjit për meje, pasi ishte krejt i përgjumur, mirëpo kur i pa në shkallë i doli gjumi.

- Babi, bretkosat!

Me atë dallim se ai nuk ndiente panik, por ishte kureshtar dhe i befasuar. Por, ai e kishte babin, babin e madh dhe të fuqishëm që i mundte të gjitha bretkosat e kësaj bote.

- Mami, jashtë janë bretkosat!

- Edhe përpara kanë mbërritur? - tha Maja.

- Po, por jo aq shumë sa këtu, dhe ia tregova hyrjen para së cilës ishte ulur Simoni dhe i shikonte bretkosat në xham, - vogëlushit po i pëlqejnë.

U gjuhëzova pranë tij dhe i pamë së bashku; zgjodhëm më të bukurën. Vërtet nuk dukeshin sulmuese. Ishin bretkosa.

- A krijohen krokodilët prej bretkosave?

I thashë jo. Ato kur rriten bëhen goxilla.

- Ti po tallesh....

- Dhe në qoftë se e përpijnë pikën e karburantit, ata vjellin zjarr, sepse benzina iu ndizet në bark.

- Ti po tallesh me mua... Goxillat nuk kanë bark.

- E, ku i fusin peshqit, pra?

Vogëlushi bluante dhe i lëshonte në vrapim ato dy elektrone në trurin e tij të vogël...

- I pjekin, pastaj i hanë.

- Jani, ta përfundojmë këtë, atëherë do të luajmë, mirë? - tha Maja, ndërsa mua më tha se duhet ta ndihmoja rreth tryeze, gjysma e së cilës ishte jashtë makine dhe që më ishte dashur ta lidhja pas një grepi në bagazh dhe te parakolpi i makinës që mos ta humbja gjatë transportit, e njëkohësisht ia kisha ngjitur sirtarët me selotejp, që të mos hapeshin gjatë lëvizjes, sepse prej saj mund të binte pushka, çiftja me gypa të shkurtuar dhe një qeskë me kokainë, e kjo do të shkaktonte problem. Po të mbushej kokaina me ujë, atë do të mund ta përdornin vetëm bretkosat, e në atë rast ato do të mund të hynin edhe nëpër dritare, gjë që nuk e dëshiroja, sepse atëherë as unë nuk do të isha krejtësisht i qetë.